

## **BOKA E KOTORRIT DHE SHQIPTARËT NDËR SHEKUJ: NDËRLIDHJA ADRIATIKASE E HARRUAR**

Ylber HYSA  
Instituti Albanologjik  
Prishtinë

Punim studimor

**Përmbajtja e shkurtër:** Kotorri me grykën e tij ka vazhduar të jetë një pikë e patejkalueshme ndërmjet Adriatikut dhe brendësisë ballkanike, një gravitim thelbësor në komunikimin historik, tregtar, kulturor dhe gjeopolitik gjatë historisë së gjatë. Kotorri në këtë mënyrë, ndër tjera, pati komunikim edhe të paevitueshëm me shqiptarët, që nuk ishin larg tij.

Fokusimi ynë i komunikimit të shqiptarëve me Kotorrin është kryesisht i kontekstit mesjetar. Në këtë aspekt, komunikimi i shqiptarëve me Kotorrin mesjetar kontekstualizohet në disa kapituj kohorë brenda sistemeve të caktuara historike.

I pari është i ndërlidhur me prezencën e hershme të bendiktinëve në Zetë e në Shqipëri të Veriut, një rol i rëndësishëm në forcimin e përhapjen e krishterimit në këto hapësira që nga shek. IX-XII. Një episod me interes i këtij komunikimi të shqiptarëve me Kotorrin ndërlidhet me promovimin e katedrales ikonike që simbolizon qytetin që nga viti 1166 si dhe rolin e klerit katolik shqiptar. Pastaj, është periudha e Nemanjiqëve kur prezenca e shqiptarëve aty ndërlidhet specifikisht edhe me atë të vllahve në rrethinat e Bokës së Kotorrit, por edhe Dubrovnikut. Konteksti tjetër është ai i periudhës së qeverisjes së Venedikut mbi këtë hapësirë dhe më gjerë mediterane, ku vetë emërtimi Dalmatia et Venetia, nënkupton një hapësirë gjeopolitike të konceptuar si Albania Veneta, pra Albania Veneciane. Një tjetër kontakt është ai i rolit që ka Kotorri si juridiksion i hershëm i kishave katolike në Kosovë dhe brendësi të Ballkanit. Një aspekt tjetër lidhet me rolin e personaliteteve nga Boka e Kotorrit në historinë dhe kulturën

shqiptare dhe diasporat e saja. Kapitull i veçantë është edhe Kotorri dhe shqiptarët pas rënies së Ulqinit dhe Tivarit në duart osmane dhe piratëria ulqinake e Bokës së Kotorrit, si dhe refleksionet detare-tregtare të një konstelacioni të ri gjeopolitik historik të kohës. Komunikimi historik i shqiptarëve me Kotorrin ka qenë shumëdimensional – politik, fetar, ushtarak, kulturor, detar etj.

**Fjalët çelës:** Kotorri, Zeta, Shqipëria, Albania Veneciane, Dubrovniku etj.

Kotorri, me grykën e tij, ka vazhduar të jetë një pikë e patejkalueshme në mes të Adriatikut dhe brendësisë ballkanike, një gravitim thelbësor në komunikimin historik, tregtar, kulturor dhe gjeopolitik gjatë historisë.

Që nga antika, Gryka e Kotorrit, apo e njohur si e Rizonit, në bazë të qytetit ilir të Teutës, pastaj atij romak, ka qenë e rëndësishme primare, falë gjeografisë specifike - fjordit më të madh në këtë pjesë të basenit të Adriatikut.

Kështu, ka ndodhur edhe në mesjetë kur Kotorri merr primatin e një vazhdimësie antike edhe pas dyndjes së popujve, përmes Bizantit në mesjetë të hershme, e pastaj, që nga sundimi i shkurtër i Mihajlit të Zetës,<sup>1</sup> Ludovikut mbretit hungarez-kroat, apo sundimet më të gjata të Nemanjiqëve e sidomos Venedikut, ka bartur këtë rëndësi edhe më përtej, në kohën më të re.

Në fakt, Kotorri një kohë të gjatë ruajti autonominë e saj të brendshme dhe nominalisht pranonte suverenitete të jashtme të fuqive të kohës.<sup>2</sup>

Pas Rizonit në antikë, Kotorri praktikisht mori primatin si qendër më e rëndësishme urbane e zonës. Njëherë si *Acruvium* antik, që si pasojë e mosmbrojtjes adekuate në kohën e dyndjeve barbare, u bart në *Catharum*, i cili si *Decadaron* përmendet për herë të parë në shek. VII

<sup>1</sup> Vazhduesi i Skilices përmend se Mihajli i Zetës e ka pasur selinë në Kotorr dhe Parpatna, Đorđe Borozan, Dinastje Vojislavleviçi, Balšići, Crnojeviçi, Cetinje, 2015, 66

<sup>2</sup> Qytete bregdetare gjatë nemanjiqëve kishin status të veçantë. Ata pranonin nominalisht pushtetin nemanjiqas, por kishin autonomi të brendshme dhe statutet e tyre. Ato vendosnin të parin e qytetit dhe kontrollonin administratën, ndërsa u paguanin Nemanjiqëve haraç e tatim vjetor në forma të ndryshme. Shih: Živko Andrijašević, *Kratka istorija Crne Gore*, Nikšić, 2019, 18

tek Anonimi i Ravenës<sup>3</sup>. Komuniteti i organizuar në kashtellin bizantin në pozicionin dominues bregor mbi detin, më vonë u zgjerua në Kotorrin mesjetar duke krijuar fortifikimin imponant nga Venediku, që shihet edhe sot.

Kotorri, apo thënë më qartë Boka e Kotorrit, ishte aty pranë zinxhirit të qyteteve antike e mesjetare në rripin e ngushtë të Adriatikut që u imponua me një kontinuitet civilizimesh që lidhën dy anët e Adriatikut. Në këtë kontekst Kotorri kishte fatin gjeografik që të ishte afër Dubrovnikut që dikur fitoi peshë e rëndësi të veçantë duke qenë vetë republikë detare - dhe kjo shpeshherë do të nënkuptonte edhe një rivalitet historik e konkurrues tregtar.

Kotorri, në këtë mënyrë, ndër të tjera, pati komunikim edhe të paevitueshëm me shqiptarët, që nuk ishin larg tij.

Fokusimi ynë i komunikimit të shqiptarëve me Kotorrin është kryesisht i kontekstit mesjetar. Pra, nuk ka të bëjë me antikën ku Boka e Kotorrit luan një rol esencial për fatin e kuptimin e Ilirisë.

Në këtë aspekt, komunikimi i shqiptarëve me Kotorrin mesjetar kontekstualizohet në disa kapituj kohorë brenda sistemeve të caktuara historike.

I pari është i ndërlidhur me prezencën e hershme të benediktinëve në Zetë e Shqipëri të veriut, një rol i rëndësishëm në forcimin e përhapjen e krishterimit në këto hapësira që nga shek. IX-XII.

Një episod me interes të këtij komunikimi të shqiptarëve me Kotorrin ndërlidhet me promovimin e katedrales ikonike që simbolizon qytetin që nga viti 1166 si dhe rolin e klerit katolik shqiptar.

Pastaj është periudha e Nemanjiqëve kur prezenca e shqiptarëve aty ndërlidhet specifikisht edhe me atë të vllahve në rrethinat e Bokës së Kotorrit, por edhe Dubrovnikut.

Konteksti tjetër është ai i periudhës së qeverisjes së Venedikut mbi këtë hapësirë dhe më gjerë mediterane, ku vetë emërtimi *Dalmatia et Venetia*, nënkupton një hapësirë gjeopolitike e konceptuar si *Albania Veneta*, pra Albania Veneciane.

Një tjetër kontakt është ai i rolit që ka Kotorri si juridiksion i hershëm i kishave katolike në Kosovë dhe brendësi të Ballkanit.

Një aspekt tjetër lidhet me rolin e personaliteteve nga Boka e Kotorrit në historinë dhe kulturën shqiptare dhe diasporat e saja.

<sup>3</sup> Meri Zorinja, *Ranosrednjevekovna skulptura na tlu Boke Kotorske*, punim doktore, Fakulteti Filzofik, Univerziteti i Zagrebit, 2014, 4

Kapitull i veçantë është edhe Kotorri dhe shqiptarët pas rënies së Ulqinit dhe Tivarit në duart osmane dhe piratëria ulqinake e Bokës së Kotorrit, si dhe refleksionet detare-tregtare të një konstelacioni të ri gjeopolitik historik të kohës.

### **Roli i benediktinëve në Zetë dhe në Shqipëri të Veriut**

Kotorri së bashku me Dalmacinë, për një kohë të gjatë, kishte qenë në administrimin bizantin që e pranonte autoritetin e tij qendror, por në aspektin kishtar ishte prore nën patronazhin e Romës dhe kjo nganjëherë harrohet. Në fakt, në liturgjitë e regjistruara të mesjetës së hershme, në disa qytete dalmate e bregdetare, përfshirë edhe Kotorrin, ishte ruajtur lutja e njohur si *Exultet*, pjesës kur lutja dhe lavdërimi i adresohet perandorit të kohës, që ishte perandori bizantin. Exulteti në këtë mënyrë është shprehje direkte e nominale e sovranitetit të pranueshëm të kohës. Exulteti i tillë është ruajtur edhe në Mesharin e njohur të Kotorrit, që është shtrirja më jugore e njohur e përdorimit të tij në Dalmaci e Adriatik Lindor.<sup>4</sup>

Kështu, pra në liturgjinë latine bekohej basileusi bizantin në qytetet dalmate (Osor, Kërk, Zarë, Rab, Trogir, Split, Dubrovnik, Kotor), e njohur edhe si *missa pro imperatore* ose si *laudes imperiales*.<sup>5</sup>

Në fakt, mendohet që exulteti u huazua si traditë nga benediktinët që në atë kohën ndodheshin të koncentruar në Italinë e Jugut, që njihte sovranitetin bizantin të kohës. Janë mu benediktinët që më vonë do të kenë një rol substancial në zgjerimin e formësimit e krishterimit dhe kulturës në këtë areal, sidomos në Zetë e në Shqipëri Veriore.<sup>6</sup>

Në këtë aspekt, Kotorri mbeti një kohë të gjatë brenda një lloj kontinuiteti romak-bizantin. Me këtë ndërlidhet edhe çështja e prezencës

<sup>4</sup> Marko Petrak, *The Byzantine Emperor in Medieval Dalmatian Exultet*, në *Byzantium in Dialogue with Mediterranean*, vol 116, f.60; Richard Francis Gyag, *Liturgy and Laë in a Dalmatian City: The Bishop's Book of Kotor*, Toronto, 2016;

<sup>5</sup> Marko Petrak, *The Byzantine Emperor in Medieval Dalmatian Exultet*, në *Byzantium in Dialogue with Mediterranean*, 63

<sup>6</sup> Lidhur me prezencën benediktine, shih edhe: J. Martinović, *Prolegomena za problem prvobitne crkve sv. Tripuna u Kotoru*, PPUD 30, 1990; J. Milanović, *Benediktinci u Boki kotorskoj*, S. Obad (ed.), *Hrvati Boke kotorske* (Jadranske studije/Zbornik Pomorskog muzeja Orebić), Orebić, 2003; I. Ostojić, *Benediktinci u Hrvatskoj*. Sv. 2: *Benediktinci u Dalmaciji*, Split, 1964; I. Pašić, *Manastir sv. Arhangela Mihaila na Prevlaci – arheološki slojevi iz 13. i sa početka 14. veka*, Glasnik Srpskog arheološkog društva 20, Beograd, 2004.

së mbeturinave martire, eshtrave të Shën Tripunit, që sipas narracionit hagiografik dhe legjendave erdhën këtu duke iu atribuuar origjinës herë nga qyteti i tij i lindjes në Frigi, herë nga Kostandinopoja, apo që janë marrë nga perandori Samuil gjatë pushtimit, apo që janë kthyer nga vetë perandori bizantin Vasili II, pas fitores së tij.<sup>7</sup>

Këtu, mbi këtë kornizë kohore dhe histori komplekse kishtare e shekullare administrative, duhet theksuar një ndërlidhje të vjetër ndërmjet pjesës së Zetës dhe Shqipërisë Veriore që ndërlidhet me aktivitetin shumë të rëndësishëm e të hershëm të benediktanëve gjatë shekujve IX-XII.

Madje, autorja Mitrović mendon që është pikërisht ky rol i hershëm krishterë benediktan që ka bërë ungjillëzimin dhe përhapjen e krishterimit, sidomos te pjesa sllave.<sup>8</sup>

Në mesjetën e hershme në Zetë dhe në Shqipërinë Veriore një varg qytetesh të mbrojtura me mure rrethuese që ishin qendra peshkopale nën juridiksionin e Romës, sikurse Arbanum, Baleco, Drishti, Dajç, Shasi, Sapa, Sarda, Shkodra etj. Bëhej fjalë për komunitete jo të mëdha, por që konsideroheshin qytete për shkak se dispononin kala të rrethuara me mure mbrojtëse, kishin statutet e tyre qytetare dhe një rregullim komunal.<sup>9</sup> Konsiderohet se romakët në këto qytete kishin sjellë edhe ingjerenat nga peshkopatat e tjera që kishin rënë në duar të gotëve, avarëve dhe sllavëve nga ekspeditat e tyre shkatërruese. Por, Tivari dhe Ulqini nuk bënin pjesë në këtë organizim, sepse ato ishin në themën dhe kastelin e Durrësit.<sup>10</sup>

<sup>7</sup> Marinko Tomasović, *Katedrala sv.Tripuna i benediktanska crkva sv.Mhovila na Prevlaci kod Tivta –primjedbe uz porjeklo oblika i datiranje, Opuscula archaeological*, Vol.37/38, No.1, Zagreb, 2014

<sup>8</sup> Katarina K. Mitrović, *Benediktinci na području Barske nadbiskupije i Kotske biskupije (9. stoljeće l 1571), Ministarstvo culture Republike Crne Gore- JU Kulturni centar "Nikola Đurkovic", Kotor, 2015; Катари́на Митровић, УЛОГА БЕНЕДИКТИНАЦАУ ЕВАНГЕЛИЗАЦИЈИ ДУКЉЕ (друга половина IX – XII век, књига 6-1, међународни научни скуп, „свети јован владимир кроз вјекове – историја и предање (1016-2016)“ Бар, 15-17. септембар 2016. године Историја, црквено предање и култ светог Јована Владимир, Цетинје, 2018.*

<sup>9</sup> Katarina K. Mitrović, *Benediktinci...*, 33

<sup>10</sup> М. Антоновић, Град и жупа у Зетском при мор ју и северној Албанији у XIV и XV век, Историјски институт. Посебна издања књ.39, Београд 2003, 22-26; Ј. Ферлуга, Драч и његова област од VII до почетка XIII века, Глас САНУ 143

Në fakt Durrësi, si një megaqendër administrative, urbane dhe peshkopale, pretendonte kontrollin mbi Zetën dhe e kishte arritur këtë në mesjetë të hershme, nganjëherë me episode.<sup>11</sup>

Siç e ka dëshmuar edhe historiani kroat Goldstein, jeta e qyteteve antike në Dalmaci dhe përgjithësisht në Ilirik e në bregdet, nuk ka pushuar me dyndjet sllave. Ata kanë penetruar gradualisht, në fillim duke shkatërruar një pjesë të vendbanimeve, apo duke u ngulitur aty me kohë, por nuk kanë krijuar diskontinuitete disfunktionale apo totale në bregdet dhe hapësirat urbane që kanë mbijetuar demografikisht e kulturalisht deri në mesjetë.<sup>12</sup> Koloriti etnik me primesa romane dhe popullatës së vjetër të mbijetuar shihet edhe më vonë në emrat e mesjetarë, si xhakoni *Albolinus*, i biri i *Bergomolit*, ndërtuesve të kishës së Shën Shirgjit në Tivat, apo të mjeshtrit *Regulus*, ndërtuesit të manastirit benediktan të shek. XI në Bogdašići.<sup>13</sup>

Kështu, në Bokë të Kotorrit është vërejtur se mikrotoponimia latine më së shumti ka mbijetuar mu duke qenë sa më pranë bregdetit për dallim prej hinterlandit dhe pjesës malore, ku me kohë u etablua toponimia sllave, gjë që fol edhe për ndryshimet etnike e demografike.<sup>14</sup>

Konsiderohet kështu që benediktanët me të ardhur në këtë pjesë të Ballkanit, sidomos në Zetë, hasën një popullatë sllave që ishte në kontakt me krishterimin e hershëm, por benediktanët luajtën rolin e ungjillzimit të hershëm duke etabluar në këto hapësira. Sipas Mitrovic, ky proces ishte i ngadalshëm, i gjatë dhe kompleks.<sup>15</sup>

Benediktinët u vendosën në këto hapësira duke rindërtuar kishat e shkatërruara paleokrishtere për të forcuar kontinuitetin e prezencës, por mbaruan edhe manastire të reja në vende të dukshme, ku kalonin rrugë të rëndësishme që lidhnin qytete, sikurse manastiri i Ratacit nga Sutomore, rrugës për Tivar, apo Shën Mihalit në Prevlakë dhe manastireve në ishujt e Bokës së Kotorrit, pranë Tivatit apo Perastit, që njëherësh

<sup>11</sup> И. Коматина, Црква и држава у српским земљама од XI до XII века, Исто ријски институт. Посебна издања књ.66, Београд 2016, 68-73

<sup>12</sup> I. Goldstein, Bizant na Jadranu od Justini jana I. do Bazilijana I. Latina et graeca, Zagreb 1992, 83-111

<sup>13</sup> M. Zorinja, op.cit, 66, 67

<sup>14</sup> G. Čulić, Mikrotoponimi u arhivskim dokumentima XIV i XV vijeka, Ime i znak života, Pomorski muzej Crne Gore, Kotor 2009, 45-78

<sup>15</sup> Катарина Митровић, УЛОГА БЕНЕДИКТИНАЦА..., 147

janë ngrehinat më të hershme benediktane në këto hapësira.<sup>16</sup> Ata ndër-tuan edhe manastiret në vetë qytetin e Kotorrit (Shën Benedikti te muret veriore afër lumit Shkurda dhe Shën Pjetri afër *via publica*)<sup>17</sup> dhe siç e pamë edhe në shumë hapësira në Shqipërinë Veriore. Këto manastire ishin ndërtuar edhe në qytete të Arbanumit më afër bregdetit si në ujdhesën e Ulqinit të Vjetër apo Manastirin e Shën Nikollës në grykëderdhjen e Bunës, Shën Joanin në Shtoj dhe Shën Aleksandrin e Shën Sofia, Shën Pali si qendër episkopale e Pultit të Epërm, por edhe më thellë në veri deri në Mirditë si në Rubik e Orosh.<sup>18</sup>

Topografia sakrale benediktine që nga bregdeti lindor adriatik nga fjordi Boka e Kotorrit e deri te Liqeni i Shkodrës dhe lumi Buna e deri në brendi të maleve të Shqipërisë Veriore flet qartazi për një rol të shtrirë e me ndikim gati unikal të tyre në Zetë e në Shqipëri Veriore.

Në fakt, kjo periudhë e hershme e krishterimit i bënë benediktanët të jenë me mjaft rol në historinë e krishterimit në Zetë e në Shqipëri Veriore deri kah shek. XII, duke i ndërlidhur në një konstelacion këto hapësira me katolicizmin.

### **Arbanasit dhe vllehtë në Kotorr**

Çështja e prezencës së vllëve dhe shqiptarëve në dokumentacionin arkivor të Kotorrit është rrethore dhe më pak e pasur se sa Arkivi i Dubrovnikut. Nga librat e Noterisë të Kotorrit janë ruajtur disa shënime indirekte nga një periudhë e shkurtër në mes të viteve 1326 - 1337. Vllehtë përmenden specifikisht në dy dokumente, por kontekstualizimi i tyre në mes të etnisë dhe profesionit të blegtorit, apo rojtarit-ushtarit-kuftarit jep më shumë mundësi të eksplorimit të kësaj tematike interesante. Sidomos nëse ajo kombinohet me të dhënat nga arkivat e Raguzës që janë më të pasura.<sup>19</sup>

Ashtu siç mendon Pijovic, vllehtë dhe *arbansit* bëhen të dukshëm në këto hapësira diku që nga shek. XIII në kohën e përkufizimit të

<sup>16</sup> Shih edhe: J. Kovačević, *Arhitektura i skulptura, IX vek, Od dolaska Slovena do kraja XII veka*, në: M. Đurović (ed.), *Istorija Crne Gore: vol. I. Od najstarijih vremena do kraja XII vijeka*, Titograd, 1967,

<sup>17</sup> Op cit, 152

<sup>18</sup> Shih edhe Lovro Mihavčević, *Po Albaniji, dojmovi pita*, Matica Hrvatska, Zagreb 1911

<sup>19</sup> Shih: Marko Pijović, *Vlasi u Dubravačkim spomenicima do 14. Stoljeća*, punim disertacioni, Universiteti i Zagrebit, 2018,

prapashpinës së Dubrovnikut, Zahumlës e Travunisë kur grupe vllsh, por me ta edhe *arbanasit*, sillen si kontigjent gjysmëluftarak në pikat vrojtuese kufitare (*vardat*) nga ane e Njemanjiqëve. Këtu të dukshëm janë sidomos vëllazëritë e njohura të Matarugëve dhe Burmazëve, të cilët përmenden në disa raste rrethanore në arkivat e Dubrovnikut. I pari i Brumazëve përmendet së bashku me të bijtë që më 1297 në dokumentacionin raguzas.<sup>20</sup>

Siç mendon Pijovic, për dallim nga Kotorri, që kishte rëndësinë primare si liman gjatë sundimit të Njemanjiqëve, por që ishte në një konkurrencë me qytete tjera në këtë kontekst administrativ të mbretërisë serbe ku hynin Budva, Tivari, Ulqini dhe Shkodra - konkurrenca ishte e fuqishme duke mos i lejuar monopol mbi tregtinë vetëm Kotorrit. Për dallim nga Kotorri, Dubrovniku e ruajti monopolin e tregtisë si liman i vetëm në tërë Dalmacinë Jugore dhe nuk kishte limane të tjera konkurruese deri në ngushticën e Neretvës apo deri në Split. Andaj, dubrovnikasit ishin të interesuar për kategorinë e vllshve si shumë të rëndësishëm në tregtinë me brendësinë e Ballkanit, e cila për shkak të relievit të papërshtatshëm malor në hinterland, bëhej kryesisht me karvanë me kuaj e mushka, që mbaheshin nga vllhtë si banues të grykave e maleve. Kotorri më pak tërhiqte një popullatë të tillë ose kishte më pak mundësi në ofertim. Por, edhe nga ato pak dokumente rrethanore, shihet burimi etimologjik arbër brenda këtij grupi që nganjëherë konsiderohej vllsh, ose që me kohë asimilohej në vllsh apo sllavë.

Kështu, Dubrovniku interesohej të mbante sa më shumë vllsh të lidhur me tregtinë e tyre andaj, burimet arkivore janë më të pasura.

Më 7.9.1331 ne dokumentet noteriale të Kotorrit lajmërohen vëllazërit Dimitri dhe Gostisha, *Demetrius et Gostisia fraters, filli Bardogne de Bastur*, të cilët kishin marrë hua 16 bagëti (*iumentas*) nga *Iohanne Basili*. Dy vëllazërit me emra kalendarikë krishterë dhe sllavë paraqiten si bij të Bardhit.<sup>21</sup>

Një rast tjetër, në Lushticën afër Bokës së Kotorrit, që ishte pronë e mitropolisë ortodokse të Zetës, në siujdhesën në mes të Kotorrit rrugës për Budva, paraqitet edhe *Miloie, fillius Bradogne de Lustiça*, i cili pranon katër bagëti nga e veja e njëfarë *Cote (Dea, uxore condam Çote de Budysa)*.<sup>22</sup>

<sup>20</sup> D.Kovačević- Kojić, *Privrdeni razovoj*, 97

<sup>21</sup> Pijović, *Vlasi u Dubravačkim spomenicima*, 116-117

<sup>22</sup> Pijovic...op.cit, 117

Në një rast tjetër, Gruspcia Tolich (Grupsa Tolic), më 2.6.1355, obligohet t'i sigurojë 80 dele dhe 30 qengja *Nutio Gille* (Nuci Gilin). Tolic duket të ketë qenë vllah që tregton me Nuci Gilin kotorras që paraqitet si ndërmjetës në shumë dokumente, pas gjasave me antroponimi shqiptarë.<sup>23</sup>

Në një rast tjetër, *Serdan fillius Peroslai Guinolloçupcich* obligohet t'i sjellë Paskal Bartollit 150 bagëti të trasha.<sup>24</sup> Pijović sheh një familje me origjinë më të hershme me antroponimi shqipe *Gjini*, sipas tij më herët të kolonizuar, e cila është akulturuar në mjedisin sllavisht-folës.<sup>25</sup>

Sipas Pijovicit, shqiptarët ishin më prezent në hapësirën e Zetës prej nga kanë arritur edhe në këto pjesë më pranë Bokës së Kotorrit në kuadër të punëve apo shtegtimeve në marrjen me bagëti. Pijović nuk llogarit këtu pjesën urbane të ndonjë familjeje shqiptare që në Dalmaci gjinden si zejtarë.

Një tjetër Gjini hetohet në dokumentin arkivor, të datës 5.9.1333, kur paraqitet njëfarë *Baroe, fillius de Gin Clachouich*, që Pijovic e sheh me ndikim gjuhësor shqiptar.<sup>26</sup>

Por, më herët se kaq, nga një dokument rrethanor nga Ragusa, bëhet fjalë për plaçkitjen që ua bëjnë disa *Albanenses* tregtarëve dubrovnikas të Berskoves mu në Kotorr, më 23.9.1278. Bëhet fjalë për një dëshmi plaçkitjeje të denoncuar nga pala e dëmtuar, tregtarët *Dimitri de Mençe* dhe *Vitagna*.<sup>27</sup>

Në fakt, nga dokumentacioni gjyqësor raguzas paraqiten për herë të parë edhe vëllazëria e njohur e Burmazëve, kur më 18.1.1287 paditën për marrjen me dhunë të një kali.<sup>28</sup>

<sup>23</sup> A.Meyer, *Monumenta Catrensia, Vol.1., fq.618*; A.Meyer, *Monumenta Catrensia, Vol 2., fq.630*; Pijovic, 119, fus.331

<sup>24</sup> Pijovic, 123

<sup>25</sup> Pijovic, 123, fus. 345

<sup>26</sup> Dëshmitar në këtë ujdi është edhe një Stepan nga Ulqini, shih, Pijovic, op.,cit, 125, fus.350

<sup>27</sup> *Nos venibamus de Brescoua in Catarum et Zayce zupparius erat nobisqum et omnes eramus in custodia Catarinoerum, quia dominus rex mittbeat nos Catarum, quando eramus capti; et eundo sic venerunt Albanenses et assaliuerenut nos, et ego dictus Demetrius fui captus, dictus uero Vitagna et Zaiucs non fuerent capti, et si dictus Zaycus fuit robatus uel acceptum ei aliquid, nesciums.* G. Čremošnik, *Kancelarsiki i notarski spisi, 1278-1301, fq.17*.

<sup>28</sup> *Lucarus Muti sacramento conqueritur dicens quod Brumassius cdum fillius suis de belemo per vim accepurunt sibi unum equum suum.* J.Lučić, *Monumenta Hisiorica Ragusina, vol.III, , 1988, 326*

Po nga dokumentet gjyqësore del edhe përmendja e parë e arbëreshëve në afërsi të Dubrovnikut, më 14.7.1284, kur për vjedhje rrushi akuzohen disa arbëreshë.<sup>29</sup>

Ajo që tërheq vëmendjen është dëshmia e Matheus, të birit të Marci de mençe: *...et audivi unam uocem clamantem in lingua albanesca.*<sup>30</sup> Kjo vërteton se gjuha shqipe ende flitej nga këta arbëreshë dhe ajo ishte e dallueshme nga tjerët, ndonëse antroponimia e përdorur nga ta tregon bashkëjetesë dhe elemente të para të asimilimit ose të bilingualizmit. Për më tepër në burime ata shquhen si *albanenses*.

Nëse shqiptarët kishin mbërritur në prapashpinën e Dubrovnikut, logjikisht ata kanë lëvizur nga Kotorri. Por, përmendja e tyre, e Buramzëve, në lokacionin specifik Belem, nga aktet gjyqësore më lart, tregon se ata ishin vendosur mu në kufirin e shtetit nemanjiqas me Dubrovnikun, që disa i ka shtyrë të mendojnë se ishin sjellë aty si ushtarë-rojtarë, ndër tjera.<sup>31</sup>

Por, ajo që duket më interesante në kontekstin e Kotorrit me shqiptarët është se në Statutin e Kotorrit të shek. XIV ndër tjerë, përmenden shqiptarët (*arbnaset, albanenses*) së bashku me sllavët dhe vllehtë.<sup>32</sup> Kjo flet për një lloj prezence apo më mirë thënë kontakti me shqiptarët në shek. XII e XIV kur ata parashihen edhe në kuadër të aktit më suprem ligjor të qytetit.<sup>33</sup>

Roli i shqiptarëve reflektohet edhe në një episod konkret. Në një moment kritik, paria e Kotorrit, pas hezitimit të Venedikut, që ta marrë këtë qytet në sistemin dhe mbrojtjen e tij - kërcënohen se ata do t'ua japin qytetin shqiptarëve, serbëve, ose turqve.<sup>34</sup>

<sup>29</sup> *Interogatus, qui fuerent qui sursum quando ramos eart respondit: Dictus Milosclaouus e Jon e Metuetus et Nicola albanense.* J.Lučić, *Monumenta Historica Ragusina*, vol.III, , 1988, 171. Në fakt, me t'u akuzuar për vjedhje rrushi pasi që kishin vrapuar punëtorët tjerë nga vreshta, këta arbëreshë kishin thënë se nuk e kanë vjedhur ata rrushin, por ua kanë marrë hajnave të tjerë rrugës, gjë që paditësve iu duk e dyshimtë si përgjigje. Pijovic, 128, fus 357.

<sup>30</sup> J.Lučić, *Monumenta Historica Ragusina*, vol.III, , 1988, 171-173

<sup>31</sup> Shih Pijovic,, vepra e cituar

<sup>32</sup> Shih: K.Jiriček, *Romani u gradovima Dalmacije*, 48-49; Ilja Sindik, *Komunalno uređenje Kotora – od druge polovine XII do početka 15 XV stoljeća*, Beograd, 1950, SAN, 39

<sup>33</sup> Pijovic këtë gjithnjë e kundron brenda shpjegimit të tij mbi klonizmin të shqiptarëve gjatë Nemanjiqëve, op.cit, 126

<sup>34</sup> Më 1396 i deleguari i kotorrasve në Venedik ua ofroi atyre qytetin me kërcënimin se nëse ata e refuzojnë, atëherë do të jenë të detyruar që Kotorrin t'ua japin shqiptarëve,

## **Lazar Albanensis, Katedralja e Kotorrit dhe kleri shqiptar i Bokës së Kotorrit**

Është interesant se peshkopi shqiptar *Lazar Albannensis* ka qëndruar në Kotorr në një episod simbolik për identitetin e këtij qyteti. Ai përmendet me rastin e një momenti shumë të veçantë për historikun e Kotorrit - ceremoninë e përirimit të katedrales së Shën Tripunit më 1166. Madje, me këtë rast, peshkopit shqiptar i kishte takuar nderi i veçantë që të përironte absidën e djathtë të katedrales që edhe sot është simbol i Kotorrit.<sup>35</sup>

Në fakt, katedralja e njohur është ndërtuar mbi kishën më të vjetër, të ngritur nga qytetar i Kotorrit, Andreaci.<sup>36</sup> Mbi të u ngrit katedralja imponante në shek. XII, e cila u përirua në ceremoninë e njohur që udhëhiqej nga peshkopi i Kotorrit Malona, peshkopi shqiptar Lazari, peshkopi i Drishtit, Martini dhe peshkopi i Ulqinit, Gjoni. Peshkopi kottorras bëri përirimin e altarit të Shën Tripunit dhe martirëve Primi dhe Felicijani, ndërsa peshkopi shqiptar Lazari altarin e Shën Mërisë së lumturuar, ndërsa peshkopi ulqinak Gjoni altarin e apostujve Gjoni dhe Palit.

Në ceremoni, përveç këtyre titullarëve kishtarë, morën pjesë edhe prelatë të lartë, si peshkopi i Shasit Pjetri dhe murgjit e manastireve benediktine, pastaj kyr Iznak, që mendohet të jetë aty si përfaqësues i pushtetit bizantin në Dalmaci. Ndërsa, merrte pjesë edhe një klerik tjetër shqiptar, priori Arbanias, Andrea.<sup>37</sup>

Pra, në këtë ceremoni madhështore për katedralen ikonike që simbolizon Kotorrin marrin pjesë klerikë të lartë që lidhen me Shqipërinë e shqiptarët, duke pasur rol qendror në këtë ceremoni përirimi me karakter historik.

---

serbëve apo turqve. Në dy rastet e para do të ishim plotësisht të braktisur, andaj do të orientoheshin në zgjedhjen e tretë. (Momčilo Spremić, *Srbija i Venecija (VI-XVI vek)*, Botimi tretë, *Službeni Glasnik*, Beograd, 2020, . 61

<sup>35</sup> Smičiklas, *Codex diplomaticus II*, 98 (19.VI.1166)...104 (29.XII.1167);

<sup>36</sup> Shih edhe: Tomislav Marasovic, *Dalmatia praeromanica, Ranosednjevokovno graditeljstvo u Dalmaciji*, 4, Split, 363; Meri Zornija, *Ranosrednjevokovna skulptura na tlu Boke kotorske*, tezë doktorature, Zagreb sipas Marko Petrak, *The Byzantine Emperor in Medieval Dalmatian Exultet* op.cit; Richard Francis Gyag, *Liturgy and Law in a Dalmatian City: The Bishop's Book of Kotor*, Toronto, 2016

<sup>37</sup> <sup>37</sup> Lenka Blehova Čelebić, 508

Por, shqiptarët dhe Kotorri ndërlidhen shumë edhe në aspektin kishtar, të historisë së kishës katolike, klerit dhe priftërinjve me origjinë shqiptare, por edhe me rolin që ata e patën si dinjitarë apo priftërinj shekullarë.

Njëri nga këto episode ndërthuret edhe situatën e historikut kompleks të Kishës Katolike rreth ndarjeve që u bënë mbi papët e Avinjonit. Në atë kohë, kur kishte rivalitete dhe anime në mes të Vatikanit dhe Avinjonit, shënohet se si një pjesë e feudalëve shqiptarë morën anën e Avinjonit. Kështu, me protopapën Klimenti VII u bënë edhe Dukagjinasi dhe Topiajt, ndërsa pjesa tjetër katolike në këto hapësira dalmate ishte me papën Urbani VI dhe më vonë Bonifaci IX në Romë. Venediku, që mbante edhe Kotorrin me hapësira përreth, ishte rreshtuar në anën e Romës. Është interesant se në këtë episod, dy vjet para se të zgjidhej kjo krizë brenda Kishës katolike, në selinë peshkopale të Kotorrit erdhi Ivani nga Durrësi, që në atë kohë qeverisej nga Topiajt. Dhe mu në këtë kohë, në krye të provincës domenikane të Hungarisë vjen edhe një Topiaj - Domeniku.<sup>38</sup>

Siç vëren edhe Blehova - Celebić, Domeniku dhe Ivani nga Durrësi me siguri ishin të afërt dhe kjo e sjell pyetjen e saj nëse Topiajt, përmes këtyre ndikimeve, dëshironin të sforconin rolin e papës së Avinjonit në një kontekst të konfrontimit jo vetëm kishtar, por mbase edhe politik.<sup>39</sup>

Kjo, sepse dihet që papa Bonifaci IX nga Roma i shkruante argjipeshkvit të Tivarit dhe vetë Gjergjit II Stracimirin Balshës që të ndërmarrin veprim ndaj “skizmatikëve”.<sup>40</sup>

Ky kontekstualizim zbërthen në prapavijë një rivalitet të konflikt ndërmjet aktorëve gjeopolitikë të kohës, ku Balshajt ishin në rivalitet të gjatë me Kotorrin, ndërsa Topiajt e Dukagjinasi po mbanin anën e tyre të interesit, me siguri duke qenë më afër lidhjeve franceze të kohës dhe ku Venediku ishte fare pranë me interesat e tij.

Një numër i konsiderueshëm i klerit katolik me origjinë shqiptare është historikisht prezent në Kotorr, madje, edhe në poste më të larta, siç ndodh me peshkopin Thomas (1334 - 1344) me origjinë nga Ulqini. Pasi që kishte kaluar kohë të konsiderueshme si peshkop i Ulqinit, atij papa i

<sup>38</sup> Lenka Blehova Čelebić, *Hrišćanstvo u Bok i 1200-1500, Kotorski Distrikt, Pobjeda*, Narodni Muzej Crne Gore, Istorijiski Institut Crne Gore, Podgorica 2006, 28

<sup>39</sup> ibid

<sup>40</sup> Ivan Božić, *Istorija Crne Gore II, 2*, 56-57; P.Rokai, *Balšići i Velika zapadna šizma*, 52-54

kishte pranuar faljen nga pagesa e servicijeve, duke e titullar si *frater Thamoas, episcopous Catharensis in Sclavonia*.<sup>41</sup>

Titulli në fjalë *Sclavonia* nënkupton juridiksionin në tokat katolike të shtetit të atëhershëm serb, edhe pse reflekton një trevë më të gjerë të përdorimit të gjuhës sllave, por që nuk përfshin ingjerenat e peshkopatës së Kotorrit mbi to.<sup>42</sup>

Në kohën e peshkopit Thomas janë marrë disa masa administrative - janë vendosur dy prokuratorë mbi secilin manastir, pastaj janë sanksionuar dënimet mbi blasfeminë, pastaj është sanksionuar mostjetërsimi nga thesari i Shën Katedrales së Shën Trifunit etj.<sup>43</sup>

Po kështu, vetëm katër vjet më vonë, peshkop i Kotorrit u bë edhe Bartolomeu (1348-1349), i cili ndenji vetëm një vit në këtë post, pasi që nga papa Klimenti VI u emërua për peshkop në Trogir të Dalmacisë, më 1349. Për Bartolomeun papa Klimenti VI i kishte shkruar car Dushanit se janë miq, *familiater notus*.<sup>44</sup> Sipas Farlatit, Bartolomeu ishte pjesë e luftës kundër herezisë në Rashkë, Shqipëri, Sllavoni së bashku me argjipeshkvin e Durrësit Antonin dhe argjipeshkvin e Dubrovnikut, Ilija Saračić<sup>45</sup>

Më vonë, gjatë kohës së peshkopit të radhës, Adamit (1349-1352), ndërlidhet një fakt interesant, kur peshkopi shqiptar Laurus e shenjtëron altarin e Kishës së Shën Gjergjit në Perast.<sup>46</sup>

Pas 24 vjetësh, në krye të peshkopatës së dioqezës së Kotorrit vihet Beranardi (1374-1375) që vinte nga Drishti, i cili qëndroi aty shkurt, vetëm një vit.<sup>47</sup>

Bernardi u trashëgua në këtë post nga domenikani që vinte nga Durrësi, Ivani apo Gjoni (1375-1397).

Për të, Blehova-Čelebić nuk përjashton mundësinë të ishte në lidhje direkte me të zotin e Durrësit, Gjergj Topiajn, si dhe me kryesuesin e provincës domenikane të Hungarisë, Dominik Topiajn.<sup>48</sup>

Gjatë peshkopatës së Ivanit ndodhi episodi interesant në historikun e Kotorrit, përplasja e në mes të mbretit hungaro-kroat Ludovikut (nën

<sup>41</sup> STAT CATH, XVIII, XIX, XCVII, CLXVIII dhe CCLX; MON MONT VI, 162-167

<sup>42</sup> M., Dinic, *O nazivima srednjekovne srpske države*, 26-28

<sup>43</sup> Lenka Blehova Čelebić, *Hrišćanstvo u Boki*...28-29

<sup>44</sup> K.Jiriček, *Istorija Srba I*, 301-304;

<sup>45</sup> Smičiklas, *Codex diplomaticus XI*, 478, 499 K.Jiriček, *Istiorija*... , 301-304;

<sup>46</sup> *Illyricum VI*, 448;

<sup>47</sup> Lenka Blehova Čelebić, *Hrišćanstvo u Boki*, 53

<sup>48</sup> *Ibid*, 53

të cilin ndodhej pushteti i Kotorrit në atë kohë) me venedikasit dhe si pasojë Viktor Pisani, i cili e administronte flotën e Shën Markut, e rrethoi Kotorrin dhe më 1378 e ktheu në dominion të venedikasve. Me këtë rast kishte ndodhur që venedikasit në shenjë triumfi kishin marrë me vete reliktin, pjesën e shputës së Shën Tripunit të mbështjellë në argjend, e cila, edhe pas shumë lutjesh të kottorasve, kurrë nuk iu kthye atyre mbrapa.<sup>49</sup>

Në fakt, më 1381, pas arritjes së paqes, Kotorri prapë iu kthye Ludovikut.<sup>50</sup>

Është interesante se në krye të peshkopatës kottorase gjendet një Kontaren (Marin Contareno 1434-1454). Kontarenët janë familje fisnike venedikase me ndërlidhje edhe me kishën, por që kanë pasur dinjitarë të shquar gjithandej në Albanian veneciane: xhaxhai i këtij peshkopi Antoni kishte qenë në biznese të mëdha me Shqipërinë sidomos me Vlorën; ndërsa Jakovi Kontareno kishte qenë dogj venedikas; ndërsa Mikele kishte bërë rrethimin e Durrësit më 1392; kurse Bartolomeu kishte qenë provizor i Lezhës (1409) dhe Albano ishte komes, princ i Shkodrës në vitet 1416-1417.<sup>51</sup>

Gjatë peshkopit me origjinë venedikase, Marcus de Nigris (1459-1474), që më me dëshirë qëndronte në Padovë se sa në Kotorr, punën e tij e kryente vikari *Petri de Brutis* që ishte peshkop i Krujës. Më vonë ky u bë edhe vetë peshkop i Kotorrit në vitet 1475-1493. Edhe pse nominalisht aty qëndroi një kohë të gjatë, ai kishte qenë zakonisht jashtë dioqezës dhe kishte lënë aty të autorizuarin, Matej de Horis.<sup>52</sup>

Atij, nga papa Pali II, i ishte dhënë Kruja në Dioqezën e Durrësit, por që nuk mund ta ushtronte punë e tij, ngase ajo pas Skënderbeut kishte rënë tashmë në duar të osmanëve.

Në fakt, *de Brutis*, përveç se kishte një origjinë të dalluar, ai ushtronte dhe funksionin me rëndësi, në krye të të famshmes **Basillicae marciae**, një institucioni edukativ me nam për priftërinjtë. Ai është dhe autor i veprës së njohur, polemikës *Victoria contra Iudeos* që

<sup>49</sup> Ky reliket gjindet edhe sot i ekspozuar në thesarin e shën Aplonit në Venedik. Shih, Lenka Blehova Čelebić, *Hrišćanstvo u Boki...*53; Farlati, *Illyricum* 453; MON MONT VI, 232

<sup>50</sup> V.Klaić, *Opis zemalja u kojima obitavaju Hrvati*, 255

<sup>51</sup> K.Mitrović, *Kotorski biskup Marin Kontareno...*, 68; O.J.Shmidt, *Das venezianische Albanien*, 396-371

<sup>52</sup> MCV (CA) 980 (17.II.1472); *Hrišćanstvo...*, 65

kundërshtonte konceptim hebraik mbi pritjen e mesisë, sepse ai tashmë kishte arritur në formën e Krishtit.<sup>53</sup>

Në peshkopatën e afërt në Risan, me një përmendje rrethanore, flitet edhe për njëfarë tivarasi *Scagni*, i cili është i përfshirë në punimet e shtëpisë së peshkopit - *iuxta domum domini epsicopi resinenis*, sipas së cilës duket që peshkopi i Risanit kishte një lloj shtëpie gjatë qëndrimit në Kotorr.<sup>54</sup>

Peshkopët me origjinë shqiptare dhe kleri tjetër nuk ishin vetëm bartës të funksioneve në Kotorr, por ata edhe qëndruan aje me raste të ndryshme. E pamë që Lazar *Albanenis* kishte qenë me një rast të veçantë në Kotorr më 1166. Pas tij përmendet më 1396 edhe peshkopi Ivan që vinte nga Triestja, por mbante titullin *episcopus arbanensis*. Në fakt, bartësi i këtij titulli shënon dioqezën shqiptare që ishte formuar në gjysmën e shek. XII mbi Krujë dhe që më vonë ishte shuar duke iu bashkangjitur asaj të Durrësit. Kjo kishte ndodhur gjatë peshkopit të fundit të kësaj dioqeze Mark Skurit.<sup>55</sup>

Është e qartë se në Kotorr, përveç në pjesën peshkopale, përmendën shqiptarët edhe në institucionin e vikarit.

Vikari, apo madje edhe vikari jashtëm, janë institucione që janë me interes për studim. Duket që ato u krijuan më qartazi gjatë shek. XV, kur në Dioqezën e Kotorrit e gjetiu filluan të dalin gjërat nga kontrolli. Kështu, bazuar edhe në Farlatin, filloi së paraqituri edhe funksioni i vikarit të jashtëm, sikurse në kohën e peshkopit Kontareno, që kishte emëruar një vikar të tillë për pjesët e dioqezës që mbulonin hapësirat nën shtetin serb të despotit Gjergji.

Më herët në kapacitetin e vikarit del një Mihali nga Durrësi, sipas shënimeve nga viti 1456 ku në margjinat e librit të akteve shënohet: *in libro actorum Michaelis de Durachio vicarii ad cartas januarii 1456*.<sup>56</sup>

Pastaj, përmendet edhe *Vicarius faraneus* Tanushi, që sipas Farlatit, më shumë se një vikar gjeneral, ishte de facto një vikar i jashtëm.<sup>57</sup> Tanushi mbante një funksion të veçantë në principatën e Serbisë si udhëheqës i një distrikti apo qarku kishtar me përgjegjësi ndaj pesh-

<sup>53</sup> Emri i plotë i veprës është *Petri Bruti Epsicopi Catharensis ad viros nobiles vicentions de omni genmere virtutis benemeritos Victoria contra Judeos*. Š.Ljubić, *Dizionario bibliografico*, 63

<sup>54</sup> IAK SN II, 546 (31.V.1398); *Hrišćanstvo...*, 67

<sup>55</sup> I.Marković, *Dukljansko-barska mitropolija*, 48-49

<sup>56</sup> BAK II, 164 (6.II.1458); *Hrišćanstvo u Boki...*, 69

<sup>57</sup> CIC, 445-450; De vicaris faraneis; *Hrišćanstvo...*, ibid

kopit lidhur me çështjet, si: shërbesa liturgjike dhe obligimet sakramentale, mbikëqyrja e sinodeve kishtare, mbarëvajtja e ekonomisë kish-tare, raportimi vjetor për gjendjen në qarkun e tij etj. Por, ai nuk e kishte të drejtën e emërimit të klerit, pasi që këtë të drejtë e kishte të rezervuar peshkopi.

Një shqiptar përmendet edhe kur bëhet fjalë për një titull tjetër interesant në hierarkinë kishtare - *Archidiaconi*. Ky titull kishte fituar rëndësi, varësisht nga konstelacionet kur dëshirohej t'i fuqizohej apo t'i kontestohet pushteti peshkopit. Por, ai zgjidhej nga kapitoli i katedrales dhe vërtetohet nga vetë peshkopi. Kështu, një diacon shqiptar përmendet në një kontekst dhe ankesë kur kanonikët e Kotorrit mbledhen pa dijen e arkidiakonit, i cili e kishte kompetencën e thirrjes së mbledhjes. E tëra është shpjeguar në kontekstin që kanonikët zakonisht i kanë ruajtur privilegjet e tyre edhe financiare duke mos pranuar aderimin e të huajve nga anash në këto kuvende. Ndaj, edhe kështu shpjegohet kjo mosmarrëveshje dhe mospërmendja e emrit të këtij shqiptari, i cilësuar si "i huaj" në këtë konfrontim.<sup>58</sup>

Si fretër laikë në Manastirin e Shën Gjergjit gjendet edhe Pali, i biri i Pjetrit të ndjerë nga Shkodra. Ai ishte pranuar nga murgu Bolica, që shpeshherë përmendet ndër burime si *oekonomus* problematik të këtij manastiri në dekadencë. Pali obligohej që me një pagë vjetore prej 12 perperësh që për 6 vite do të qëndronte dhe shërbente në manastir, ku do të ushqehet, por veshmbathjen duhet ta siguronte vetë.<sup>59</sup>

Sa i përket manastireve, është interesante se manastiri i parë domenikan në Kotorr (nga vitet 1260-1271) kishte për ktitor Buqan, qytetarin kotorras, që i kishte dhuruar ndërtesën dhe disa ara tek fra Konstantini nga Durrësi.<sup>60</sup>

Është për t'u theksuar se, edhe përkundër faktit se kleri katolik ishte ndërkombëtar dhe mbahej përmes universalizmit të kishës katolike - e që shihet edhe nga prezenca e madhe e klerit të huaj në Kotorr e dukshme edhe nga agjenda noteriale dhe Statuti – prapë se prapë fërkimet e vendasve me të huajt janë evidente.

Kështu, nga rregullorja statutore e vitit 1379, urdhërohet që për shkak të dëmeve që janë krijuar nga nikoqirllëku i pakujdesshëm i të

<sup>58</sup> *Hrišćanstvo u Boki...*,73

<sup>59</sup> Op.cit, 123

<sup>60</sup> S.Krasić, *Domenikanci u Bokokotrskom zaljevu od XIII. Do XIX. Stoljeća*, në *Hrvatska Obzorja*, 2001, /2, 357

huajve nga Shqipëria nëpër kisha, urdhërohej në të ardhmen që asnjë patron kishtar të mos lejonte që për abat, murg, apo udhëheqës të kishës të ketë një të huaj. Dënimi për mosrespektim të kësaj rregulle ishte i lartë, plot 100 perperë së bashku me humbjen e privilegjeve në institucionin kishtar, përfshirë edhe të drejtën e votës.<sup>61</sup>

Një hezitim për përfshirje të të huajve shihet edhe nga kërkesa që të parët e qytetit ia drejtojnë Kapistranit, më 1455, me kërkesën që t'i dërgojnë fretër françeskanë, por me një preferencë që ata të jenë italianë e dalmatë, por jo boshnjakë.<sup>62</sup>

Në fakt, vërshimi i klerikëve shqiptarë në Kotorr e Dalmaci duhet parë në dritën e zhvillimeve politike. Së pari, me një kornizë të njëjtë qeverisëse të Albanias Veneciane, mundësohet një lloj mobiliteti edhe i klerit katolik, por më vonë rrethanat ndryshojnë tërësisht me okupimet otomane, kur ndihet një ndrydhje e këtij faktori, që kërkon të gjejë një fat më të mirë.

Arsyet e tërheqjes së klerit shqiptar duhet kërkuar edhe në kushtet shumë të rënduara kur benefitet e manastireve dhe kishave të tyre nuk ishin më në gjendje t'i ushqenin e t'i mbanin dhe ata kërkonin shpëtim gjetiu.

Në Kotorr po ashtu u strehuan shumë shqiptarë pas Luftës së Dytë Shkodrane (1419-1423).

Kështu, në dokumente dhe akte noteriale, gjendet një numër i madh i klerit që mban veçorinë e spikatur *albanenses*, siç do të shihet në këtë tekst. I tillë ishte edhe Dominiku (Domenicus Albanenses) që paraqitet në Kotorr më 1332<sup>63</sup> e që më vonë shihet të ketë shkuar si prift në ujdhesën e Lastovës, nga aktet papale (*Domincus Albanensium presbiter in Insula Lagusta*).<sup>64</sup>

Po kështu, në listën e fretërve të *Frater Minor* në Kotorr përmendet edhe Fra Gion nga Shkodra.<sup>65</sup>

Kishte të tjerë, që po ashtu zinin vende me rëndësi dhe poste të ndryshme në hierarkinë kishtarë, por edhe të tillë që ishin në kalim e sipër. I tillë ishte Ivani nga Triestja që u gjet në Kotorr më 1397, si pesh-

<sup>61</sup> STAT CATH CXXIV, Quod nullus forensic possit esse electus abbas aliucius ecclesiae.

<sup>62</sup> L.Ėadding, Annales minorum XI, 246, XXII; Hriščanstvo ..., 231

<sup>63</sup> MON CAT II, 172 (8.XI.1332);

<sup>64</sup> J.Neralić, *Diplomatski izvori*, në: *Tisuću godina uspostave dubrovačke (nad)biskupije*, 80

<sup>65</sup> IAK SN II, 463 (26.IX.1397)

kop i Albanias, që po qëndronte aty me detyrë të caktuar: që të bënte shpagesën e dëmit për vojvodën Sandal Hraniq dhe gruan e tij Jelena Balsha, të shkaktuar nga fisniku malazez, Radiq Cernojeviq.<sup>66</sup>

Pas luftës së Shkodrës, të viteve 1419-1423, në Kotorr, së bashku me refugjatë, u strehuan edhe mjaft klerikë nga Shkodra e Durrësi. I tillë ishte domenikani nga Shkodra Dhimitri, të cilit me qira iu pajtua shtëpia në Prqanj më 1443, pronë e Manastirit Shën Nikolla në Kotorr. I njëjti, së bashku me murgj të tjerë, Bazilin e Licas dhe Mihën Buqan, do të jetë nënshkrues në emër të këtij manastiri.<sup>67</sup>

Në Kotorr gjeti strehim edhe kleriku ulqinak Sergji, si kapelan i mëvonshëm i Kishës së Shën Tripunit, më 1492.<sup>68</sup>

Të njëjtin fat e kishte edhe një i mërguar nga Durrësi, diakoni Gjergj Romani, i cili ishte ngritur nga peshkopi Faseolo në kanonik, më 1458.<sup>69</sup>

Të tjerët shfrytëzonin Kotorrin si stacion të ndërmjetëm duke kërkuar fatin më të mirë, siç kishte qenë rasti me Paskal Pribin nga Shkodra, i cili, me ndihmën e një ushtaraku venedikas në kështjellën e Kotorrit, arriti të shkonte në Venedik.<sup>70</sup>

Shumë nga këta klerikë, që po kërkonin një fat më të mirë, qoftë si refugjatë, qoftë të larguar për shkaqe të rënduara ekonomike në dioqezat e tyre të degraduara nga lufta dhe skamja, ia mësynin Kotorrit, që duket se ishte i stërm bushur dhe kishte më pak mundësi t'i adoptonte këta, ndaj shpesh qytete e tjera dalmate, sikurse Dubrovniku, dukeshin stacioni i ardhshëm e më i favorshëm në këto raste. Kështu, në Raguzë kishte mbaruar Dhimtër Spani, nga familja e njohur fisnike shqiptare.<sup>71</sup>

Tjerët kishin mërguar në Kosovë, në Prishtinë, ku kishte një bashkësi katolike, apo edhe gjetiu.

Pas rënies së Ulqinit dhe Tivarit shumë shqiptarë migruan në territoret venedikase, në Budvë dhe në Kotorr.<sup>72</sup> Atëherë, shumë shqiptarë, si njohës të terrenit dhe të gatshëm për t'u rebeluar kundër pushtimit otoman u imponuan si aktorë kryesorë dhe ndërmjetës në planet ambicioze

<sup>66</sup> IAK SN II, 439 (10.V.1397)

<sup>67</sup> *Hrišćanstvo u Boki...*, 232

<sup>68</sup> BAK III, 311 (4.II.1492)

<sup>69</sup> BAK II, 29 (28.V.1458);

<sup>70</sup> IAK SN XIX, 19 (11.X.1493)

<sup>71</sup> I.Božić, *Spani-Španje*, 39-40

<sup>72</sup> Gligor Stanojević, *Dokumenti o zavjeri albanskih prvaka iz 1602. godine, Balcanica 3, Godšinjak Balkanološkog Instituta, SANU, Beograd, 1972, f.300*

të politikave papale për t'i çliruar këto territore nga ndikimi otoman, sidomos nga fundi i shek. XVI deri tek Lufta e Kandisë. Por, Venediku ishte shumë i kujdesshëm në këto përpjekje duke mbrojtur politikën e status quo. Providuri në Kotorr ishte shpesh referencë në shumë nga këto episode.

### **Priftërinj nga Boka e Kotorrit dhe diplomacia skënderbejane**

Argjipeshkvi i Tivarit, Andreu, që ishte në krye të kësaj qendre më të rëndësishme katolike përreth, gjatë viteve 1448-1460, u angazhua nga Skënderbeu për disa shërbime diplomatike.

Ai ishte me origjinë nga Mula në Bokë të Kotorrit. Ishte françeskan dhe teolog në Zarë para se të merrte postin me rëndësi si argjipeshkëv.<sup>73</sup>

Në viti 1450 Skënderbeu e kishte lutur atë që të ndërmerre një vizitë në Vatikan te papa për të kërkuar ndihmë urgjente kundër depërtimeve otomane që kanoseshin seriozisht në këtë pjesë të Ballkanit.

Argjipeshkvi Andrea nuk jetoi gjatë, pas dorëzimit të postit si argjipeshkëv dhe vdiq dy vite më vonë, më 1462.<sup>74</sup>

Gjergj Pelini është prift dhe diplomat që ka tërhequr vëmendjen e historianëve dhe rrjedhimisht për të është shkruar shumë, marrë parasysh aktivitetin e tij kompleks. Por këtu do t'i referohemi vetëm në kuadër të temës që ka të bëjë me Kotorrin e shqiptarët.

Pelini, ndonëse i vendosur në manastirin benediktan të Shën Mërisë në Rotecco (Ratac), pra fare afër Tivarit në Sutomore, më shumë u mbajt me Kotorr se sa me vetë Tivarin. Kjo, siç e cek edhe Blehova-Čelebić dhe të tjerët, për tri arsyeje: Pelini mbahej si pretendent real për të marrë Argjipeshkvinë e Tivarit, për cka suportohet nga venedikasit, por ishte pranuar me shumë xhelozë nga vendorët në Tivar dhe fisi i Mërkojeviqëve në afërsi, apo nga Stefan Vukčić Kosaqa që e kërkonte kokën e tij; mëria ndaj tij vinte dhe për arsye se ai dallohej shumë nga rrethi për shkak të arsimimit dhe përgatitjes superiore ndaj tjerëve; Pelini po ashtu, duke fituar titullin protonotor papal kishte komunikime direkte me Dubrovnikun, Venedikun dhe Vatikanin duke anashkaluar kështu çfarëdo hierarkie lokale.

<sup>73</sup> *Hrišćanstvo u Boki...*, 233

<sup>74</sup> Farlati, *Illyricum* VII, 85;

Pelini arriti të bënte karrierë të shquar diplomatike. Së pari si diplomat në shërbim të Vuk Brankovic dhe pastaj luajti rol në nënshkrimin e marrëveshjes venedikase-serbe në Vuçitërn pas Luftës së Dytë të Shkodrës. Më vonë ai u shqua si diplomat në funksion të Skënderbeut karshi Venedikut e papatit, por kreu shërbime ndërmjetëse edhe për Venedikun karshi Skënderbeut, që nga negocimi për Krujën. Më vonë ishte ndërmjetës edhe në konfliktin në mes të Skënderbeut e Lekë Dukagjinit dhe venedikasve. Për gjitha këto ai ishte shpërblyer majmërisht me të holla nga Skënderbeu, venedikasit etj. Pelini kishte ndërmjetësuar edhe në mes të Skënderbeut e papës Kaliksit dhe kishte qenë në funksion të përbashkët diplomatik me Gjin Gazullin. Ai njihej edhe së përpilues i shkresave diplomatike të Skënderbeut.<sup>75</sup>

Pelini kishte qëndruar me ëndje në Kotorr dhe aty paraqitet në një sërë dokumentesh e funksionesh nga më të ndryshmet.

### **Kotorri dhe Kosova**

Kisha katolike në Novobërdë ka qenë në juridiksionin administrativ të Kotorrit.<sup>76</sup> Kishën sase e përmendin për herë të parë më 1346 dhe pastaj ajo gjendet edhe në një varg burimesh të tjera.<sup>77</sup> Konsiderohet

<sup>75</sup> Shih: Ivan Božić, *Nemirno Pomorje XV veka*. Srpska književna zadruga, 1979; Lovorka Čoralić, *Barani u Mlecima: povijest jedne hrvatske iseljeničke zajednice. Dom i Svije, 2006t*; Zarij M. Bešić, *Istorija Crne Gore, Volume 2,II*, Titograd, 1970; Robert Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*. I.B.Tauris, 2002; Savo Marković, "Benediktinska opatija svete Marije Ratačke kod Bara, Acta diplomatica et iuridica". *Croatica Christiana Periodica*. 28, 2004; Risto Kovijanić; I. Stjepc̃ević (1957). *Kulturni život staroga Kotora, XIV-XVIII vijek: Ljekari. Apotekari. Apoteke.*; M.Spremic, Ratačka opatija kod Bara, 204; Jahaja Drancolli, Raguzanët në Kosovë, Rilindaja Prishtinë; Lenka Blehva- Celebic, Hriscanstvo u Boki...

<sup>76</sup> Тајјана Стародубцев, Прилози проучавању цркаваи манастира осниваних или обнављаних у области Бранковића од 1371. до 1455 године, II део, 70, Прилози проучавању цркава и манастира осниваних или обнављаних у области Бранковића од 1371. до 1455. године. II део, Косовско-Метохијски зборник 6, Београд 2015, 65-95.

<sup>77</sup> З. М. Динић, За историју рударства II, 93; В. С. Јоановић, Ново Брдо 98, 106.24 В. С. Јовановић, Ново Брдо град заиста сребрни и златни, 80, 110; М. Ћоровић-Љубинковић, Археолошки и историјски значај 261; М. Љубинковић, Ново Брдо средњевековни град 229; М. Ћоровић-Љубинковић, Значај Новог Брда, 133; Ђ. Бошковић, Археолошка истраживања, 109; М. Ивановић, Задужбине Косова, 402; В. С. Јовановић, Ново Брдо, 30, 106.

se përmendja sipas Arkivit të Dubrovnikut të *Santa Maria de Dolni Targ* i referohet mu kësaj kisha, që e përmend edhe Marin Bici në raportin e tij, „Làlontano à mezzo miglio, ci è un'altra chiesa bella e grande soto titolo della Madonna, capace di 3 mi persone ed un bel porticogrande adornato di belle pitture“.<sup>78</sup>

Kisha katolike e Novobërdës sillet në relacion me Novobërdën përmendet edhe në burime tjera.<sup>79</sup>

Kisha njëaniatëshe më e thjeshtë ishte rinovuar më vonë duke marrë përmasa më imponante, që qartazi tregon se ajo i shërbente një komuniteti katolik në rritje.<sup>80</sup>

Në afërsi të Prishtinës ekzistonte një kishë tjetër katolike kushtuar Shën Mërisë që përmendet më 1387 gjatë ndërtimit dhe pastaj më 1442.<sup>81</sup>

Kisha në fjalë nuk është ubifikuar dhe mendohet se ajo është ndërtuar një kohë më të gjatë.<sup>82</sup>

Kisha katolike përmendet edhe në Prizren.<sup>83</sup>

Është interesante se në fillim këto kisha ose ndërtohen nga kotorrasit ose janë nën patronazhin dhe juridiksionin e peshkopit të Kotorrit, por kjo ndryshon më vonë gjatë venedikasve kur Argjipeshkvia e Tivarit merr një primat mbi to. Këtë e përdorin me shkathtësi edhe dubrovnikasit që shpërndajnë klerin e tyre katolik mbi këto kisha gjatë Despotatit serb dhe më vonë gjatë Perandorisë Osmane. Më vonë, gjatë kundërreformacionit dhe Kongregatës së Fesë janë domenikanët dhe françeskanët ata që ushtrojnë kontroll mbi këto kisha, nganjëherë duke pasur edhe rivalitete të theksuara. Në fakt, argjipeshkvi i Tivarit histo-

<sup>78</sup> Fr.Rački, *Izveštaj barskoga nadbiskupa Marina Bizzia*, 123; ; M. Љубинковић, Ново Брдо средњевековни град, II, 95

<sup>79</sup> J.Neralić, *Diplomatski izvori...*, në: *Tisuću godina uspostave durovačke (nad)biskupije*, 102 (10.XI.1390); Blehova-Čelebić, 426

<sup>80</sup> I. Zdravković, *Arheološko-konzervatorskiradovi*, 340; V. С. Јовановић, *Ново Брдо – град заиста сребрни и златни 110 и сл. 12*; Ђ. Бошковић, *Археолошка истраживања* 108–109; М. Ивановић, *Задужбине Косова*, 402; М. Такаџ, *Sächsische Bergleute*, 45–50; Е. Чершков, *Сашка црква код Новог Брда* 338–339;

<sup>81</sup> С. Ђирковић, *Католичке парохије*, 249; М. Спремић, *Деспот Ђурађ Бранковић*, 735

<sup>82</sup> Т. Стародудџев, *Прлози...* op.cit, 74

<sup>83</sup> Thalloczy-K, Jireček-Sufflay, *Acta et dilomatica...* II, 20 (6.1.1346); J.Kalić, -Mijušković, *Beograd u srednjem veku*, 73-76, 306-307, 361-362; Blehova-celebic, 426

rikisht është autoriteti suprem dhe më i hershëm i katolicizmit në këto pjesë të Ballkanit.<sup>84</sup>

Organizimi kishtar në Kotorr dallon në mesjetë dhe ai është me një historik kompleks e dinamik.<sup>85</sup>

Në fakt, Kotorri në fillim të eksplorimit të xehetarisë në mesjetë në Kosovë dhe rajon prin duke përdorur një pozitë të privilegjuar brenda shtetit mesjetar serb dhe despotatit, si një liman me shumë favore. Kotorri gjithnjë ka ruajtur një pozicion autonom me statutin e qytetit dhe përfaqësimin e tij, por ai ka shtrirë ndikimin në fillim edhe me juridiksion kishtar dhe me ndikim në stile ndërtimesh të katedraleve në Kosovë e gjetiu, qoftë në ato katolike, qoftë ortodokse.<sup>86</sup>

<sup>84</sup> G.Gjini, Arqipeshkvia Shkup-Prizren...; Daniel Fralati, Jakob Koleti, Ilyricum Sacrum, VII/1, Arqipeshkvia Mitropolitane Shkodër-Pult, 2019; Antal Molnar, Confessionalization on the Frontier, The Balkan Catholics between Roman reform and Ottoman Reality, Viela, Rome, 2019; И. Божић, О јурисдикцији которске дијецезе у средњовековној Србији; И. Божић, Немирно Поморје XV века, Београд 1979 (= Споменик САН СП, 1953, 11–16), 15–27; М. Антоновић, Папство и Србија у XV веку додатак ИГ 1–2, 1993, 34, 62; М. Спремић, Односи између православних и римокатолика у српској Деспотовини, пë: Црква Светог Луке крозвјекове, 239–253; С. Ћирковић, Католичке парохије у средњовековној Србији, С. Ћирковић, Работници, војници, духовници, 240–258

<sup>85</sup> Në mesjetë Dioqeza e Kotorrit nuk përfshinte as Budvën dhe as Risanin, madje as Hercegovin, i cili ishte nën peshkopatën e Trebinjës atë kohë. Peshkopata e Budvës kalon nën Kotorin dhe më vonë Tivarin vetëm pas kontrollit venedikas në këto hapësira më 1570. Peshkopata e Risanit u shua kur ky qytet kaloi në kontrollin otoman (1539).

Peshkopët e Kotorrit kanë qenë historikisht nën patronazhin e Solinit, respektivisht Splitit, pastaj Duklës dhe Tivarit, mandej Dubrovnikut dhe më vonë më 1025 ose 1172 (e deri me 1828) nën mitropolinë e qytetit italian Bari. Nën Kotorin një kohë kishin hyrë edhe kishat nën mbretërinë e despotatit serb. Shih: Blehova-Čelebić, ... 418

<sup>86</sup> Për kishat katolike të kësaj periudhe në Kosovë, shih: Rokšana Ratkovčić, *Katolička crkva Sv. Petra i dubrovačka kolonija u Starom Trgu kod Trepče*, *Ars Adriatica* 7, 2017; Aleskadnar Deroko, *Monumentlana i dekorativna arhitektura u srednjevekovnoj Srbiji*, Beograd, 1985; Marica Šuput, *Crkva u Starom Trgu*, *Zbornik Filozofskog Fakulteta*, Beograd, XII-1, 1974; Dragan Qukiq, *Kosova monumentet dhe bukuritë*, Lidhja Turistike e Kosovës, Prishtinë, 1971, Sulejman Murati, Mustafa Shukriu, *Pesëdhjetë shekuj të Mitrovicës*, Mitrovicë, 1971, Jusuf Osmani, *Vendbanimet e Kosovës*, Mitrovica, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, Prishtinë, 1971; Gjon Berisha, *Organizimi kishtar në Kosovë gjatë Mesjetës*, Prishtinë, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2014; Gaspër Gjini, *Skopsko-Prizrenksa biskupija...op.cit*

Një pozitë e këtillë e privilegjuar karshi komuniteteve katolike këtu u sfidua nga rivalët qytetet bregdetare, sidomos dubrovnikasit, që arritën të imponoheshin me rrjetin e tyre tregtar e diplomatik, madje edhe më vonë në periudhën e hershme osmane.<sup>87</sup>

### Zmajevic dhe Koncili i Arbnit

Ndërlidhja e një personaliteti nga Boka e Kotorrit me shqiptarët është e një rëndësie të madhe për historinë e këtyre kontakteve.

Bëhet fjalë për (Vincencio) Vicko Zmajevic i lindur në Perast, afër Kotorrit (23.XII 1670) dhe vdekur në Zarë (11.IX.1745). Ai ishte peshkopi i Tivarit që ka organizuar episodin tejet të rëndësishëm për historinë dhe gjuhën shqipe - Koncilin e njohur të Arbnit, në Mukje më 1703, në kohën e papa Klimentit, me prejardhje shqiptare.<sup>88</sup>

Vicko Zmajevic është nga familja e njohur perastane Zmajevic, që ka dhënë personalitete të shquara sikurse argjipeshkvi Andreja Zmajevic (1625-1694), vikar apostolik në Budvë dhe peshkop i Tivarit.<sup>89</sup>

Matija Zmajevic është admiral i njohur i Rusisë së kohës së Pjetrit të madh, që ka bërë nam në betejat në Baltik etj.

Vicko ka kryer teologjinë e filozofinë në Romë, ka qenë prift në Shën Jurij në Perastin e lindjes gjatë viteve 1695-1701, ndërsa më vonë u bë peshkop i Tivarit, si dhe *primas Serbiae* në vitet 1701-1713 dhe më vonë peshkop i Zarës në vitet 1695-1701.<sup>90</sup>

Ai ishte edhe vizitator papal për vendet e Ballkanit nën Perandorinë Otomane dhe si i tillë kishte një rol me rëndësi në ndikimin e politikave papale për Ballkanin.

<sup>87</sup> Jahja Drancolli, *Në kërkim të historisë mesjetare arbërore*, Unioni i shqiptarëve në Republikën e Kroacisë, 167; Branislav Milutinovic, *Veze Bogdana Krizmića sa Dubrovnikom* (1359-1371), Vjetar, XXI-XXII, Prishtinë.

<sup>88</sup> Shih dhe: Peter Bartl, Injac Zamputi, *Vincezo Zmajevich, Relacion i gjendjes së Shqiperisë e Serbisë (1702-1703)* (Albert Ramaj ed.) Albaniches Institut, St.Gallen-Prishtinë, 2022

<sup>89</sup> <http://www.catholic-hierarchy.org/bishop/bzmaieva.html>; John V. A. Fine, Jr. *When ethnicity did not matter in the balkans: a study of identity in pre-nationalist croatia, dalmatia, and slavonia in the medieval and early-modern periods*, *ann arbor, mich.: university of michigan press*, 2006.

<sup>90</sup> Shih: Zdenko Dundeović, *Prilog poznavanju arhivskog gradiva Zadarskom Nadbiskupu Vicku Zmajevicu (1713. – 1745.)*, Teološko-katehetski odjel Sveučilišta u Zadru, 57-76; Pavao Butorac, *Vicko Zmajević (1670-1745)*, Hrvatska Smotra, XV, n.3, Zagreb, 1928

Është autor i shumë trakteve dhe polemikave dogmatike-teologjike në gjuhën latine, italiane, sllave dhe gjuhën shqipe.<sup>91</sup>

Organizimi i Kuvendi të Arbnit është një vepër madhore e tij që pati ndikim të madh në riorganizimin dhe mbajtjen e katolicizmit tek shqiptarët.<sup>92</sup>

Vepra e botuar në latinisht e shqip është autorësi e tij.

Vepra në fjalë ka rëndësi primare edhe për historinë e gjuhës shqipe dhe për rrethanat e kohës që kanë të bëjnë me historinë e shqiptarëve në këtë kohë.<sup>93</sup>

Është edhe një moment që e ndërlidh peshkopin Zmajevic me shqiptarët. Ai është njeriu që ka mundur shpërnguljen e arbëneshëve nga rrethinat e Liqenit të Shkodrës dhe Krajës në Zarë dhe ka organizuar vendbanimin e tyre që edhe sot ekziston si Arbanasi (Arbneshi) dhe ka ndihmuar komunitetin arbëresh me të holla të veta që të krijojnë kishën e tyre kushtuar zonjës së Loretos, që edhe sot qëndron si simbol i tyre.<sup>94</sup>

Zmajevic ka qenë ithtar i koncepti uniat roman për çka edhe ka shkruar dhe me këtë qëllim ka synuar krijimin edhe të kolegjit glagolitic

<sup>91</sup> Zmajević, Vicko. *Hrvatska enciklopedija, mrežno izdanje*. Leksikografski zavod Miroslav Krleža, 2021. Pristupljeno 21. 2. 2022.

<http://ëëë.enciklopedija.hr/Natuknica.aspx?ID=67335>; *Izabrana djela nadbiskupa Vicka Zmajevića*, Zagreb, Salesiana, 2015

<sup>92</sup> Shih: *CONCILIUM PROVINTIAE ARBENIT* (Romae 1706), Botime Franqeskane, Shkodër, 2012

<sup>93</sup> Historia e letërsisë shqipe, (grup autorësh), Rilindja, Prishtinë, 1989; Robert Elsie, Letërsia shqipe, Dukagjini, Pejë, 1997; Roberti Elsie, Letërsia shqipe, një histori e shkurtër, Skenderberg, Tranë. 2005

<sup>94</sup> Shih literaturë mbi Arbëneshët e Zarës: Niko Marovic, *Nesto o Arbansima Kod Zadra*, Novo Doba, Split, 1941; Niko Karuc, *O zadraskim Arbanasima*, Zadar, 1985; Niko Karuc, *Uzroci seobe zadarskih Arbanasa*, Glas Zadra, Zadar, 1954; Kruno Krstic, *Doseljenje Arbanasa u Zadar*, Zadar, Zbornik, Zagreb, Matica Hrvatska, 1964; Aleksandar Stipcevic, *Kultura tradicionalne e arbëneshëve të Zarës*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012; Maximiljana Barancic, *Arbanasi i etnojezicni identitet*, Croatica et Slavonica Iadertina, Zadar, 2008; Idiz Ajeti, *Istorijiski razvitak govora Arbanasa kod Zadra*, Sarajevo, Djela, knj/VXI, Balkanolski Institut, knjiga 3, Sarajevo, 1961; Vanda Babic, *Bozicni obicaji u Zadru (Arbanasi i puntamika)*, Crkva u svijetu, 48 (2013), br.3; Bernard Kotlar – Drago Maric, *Kazivanje nasih starih o radiciji Zadarskih Arbanasa*, Zadar, 2016; *Arbëneshët e Zarës, Historia dhe etnokultura e tyre*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2016; Ahmet Kelmendi, *Diaspora shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1970 (4.XI-10.XI); Ernest Koliqi, *Hija e maleve*, Zara, 1929;

në Zarë më 1748, por të cilit i shihet për të madhe nga ortodoksët për qëndrimet e tij.<sup>95</sup>

Katedralja e Perastit edhe sot mban mbishkrimin për nder të bashkëpatriotit perastas Vicko Zmajevic me shënimin nergut si autor i Koncilit të Arbnit, si njëra nga veprat e tij jetësore, që jetësohet në këtë plakete guri në murrin e kishës që mund të lexohet edhe sot.<sup>96</sup>

Por, Boka e Kotorrit, përmes Zmajevicit, nuk e mbaron historikun e saj të ndërlidhur me diasporën shqiptare.

Në fakt, duke qenë pjesë e Albania Venetianas, pas rënies së pjesës arbërore të saj (Shkodrës, Lezhës, Drishtit etj), Boka e Kotorrit shërbeu ose si stacion tranzitor i diasporës arbërore për më tuje në Zarë, Dubrovnik, apo Venedik e Itali, por edhe si vendstrehim apo atdhe i ri për mjaft arbërorë që u tërhoqën pas rënies së Shkodrës më 1571.<sup>97</sup>

Nga familjet e njohura nga Boka e Kotorrit që kanë origjinën nga hapësirat arbërore përmenden Sbutega, Lindi etj.

Lindi janë familje të vendosura në Perast.<sup>98</sup> Ata konsiderohen tani ndër familjet më të vjetra në këtë qytet bregdetar me histori të veçantë, që theksojnë ekzistencën mbi katërqindvjeçare në këtë vend.

Sbutega janë familje me histori e nam në Bokën e Kotorrit.<sup>99</sup>

Po ashtu, përmenden gjurmë të këtyre familjeve në Muo pranë gjirit të Kotorrit<sup>100</sup>.

<sup>95</sup> “il” nazionale: periodico politico e letterario, volume 1, 1862, zare,

[https://books.google.bg/books?id=rV6Ovx1iiIC&pg=PA106&lpg=PA106&dq=ko+su+zmajevici&source=bl&ots=4a5UluUGNs&sig=ACfU3U3TK\\_X\\_IMFyyISrNHmS1HQ1L4AnfA&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEëi\\_8p6h\\_5D2AhEBSPEdHVP\\_AR8Q6AF6BAGEAM#v=onepage&q=ko%20su%20zmajevici&f=false](https://books.google.bg/books?id=rV6Ovx1iiIC&pg=PA106&lpg=PA106&dq=ko+su+zmajevici&source=bl&ots=4a5UluUGNs&sig=ACfU3U3TK_X_IMFyyISrNHmS1HQ1L4AnfA&hl=en&sa=X&ved=2ahUKEëi_8p6h_5D2AhEBSPEdHVP_AR8Q6AF6BAGEAM#v=onepage&q=ko%20su%20zmajevici&f=false)

<sup>96</sup> Mishkrimin e ka parë autori. Nuk kemi dijeni që për këtë është shkruar më herët. Besojmë se kjo është e rëndësishme edhe për historinë kulturore të shqiptarëve.

<sup>97</sup> Shih, Lucia Nadin, *Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (Nga Historia te Miti: Shekujt XV-XVIII)*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2018, 37

<sup>98</sup> Marko Lindi, njeriu i dytë i qytetit të Perastit pranon origjinën e tij arbërore të dokumentuar në Arkivin e Parastit. Bisedë personale e autorit me të.

<sup>99</sup> Antun Sbutega, professor dhe ambasador i Malit Zi në Vatikan, don Brano Sbutega (1952-2006), fëmullitar, intelektual, aktivist kulturor, etj.

<sup>100</sup> I ndjeri argjipeshkëv i Peshkopatës Prizren-Shkup Nikë Prela \*1918-2016) është nga Muo. Ai lindi në Kotorr dhe shërbeu edhe në Muo e Sutomore në Mal të Zi. . Shih edhe:

<https://ëëë.vaticanneës.va/sq/bota/neës/2020-02/ipeshkvi-shqiptar-imzot-nike-prela-me-24-vjetorin-vdekjes.html>;

Në fakt, Andrija Balović (1721-1784) në *Analet* e tij thekson se në Perast nga Shqipëria janë vendosur disa familje të njohura, si: Bronza, Vitnić, Balović, Lalović, Šilopi, Zubac, Smiljević dhe Sakolević.<sup>101</sup>

Është interesante edhe përmendja e pseudonimit “Goga” në Bokë të Kotorrit për shqiptarët, në fakt për mjeshtrit e njohur muratorë dhe ndërtues shtëpish që njiheshin edhe si “mistri Goghe”.<sup>102</sup>

### **Albania Veneciane – si kufi i ri gjeopolitik**

Në luftën domethënëse të vitit 1571, kur Ulqini e Tivari ranë nën sundimin Osman, shfaqet një komandant interesant në anën e venedikasve, Fran Dukagjini. Ai kishte qenë pjesë e dy prijësve ushtarakë që Venediku urgjent i dërgoi në teatrin luftarak: Vlatko Kosaqen në Hercegovinë kah e kishte origjinën, ndërsa Fran Dukagjinin e kishte sjellë me shpejtësi si përforsim në Shqipëri me 80 ushtarë profesionistë.<sup>103</sup> Dukagjini kishte vërejtur se nuk ekzistojnë kushte për një aksion ofensiv ushtarak dhe së bashku me Kosaqën ishin kthyer në Senatin venedikas për të raportuar mbi situatën në terren.<sup>104</sup> Mirëpo, Venediku duke u ngutur për kundërveprim solli në këto hapësira Diacom Malatesta ambicoz me 2500 ushtarë, i cili pësoi debakël. Malatesta ishte njohur me kontin e Ulqinit Brutin dhe pas dështimit të tij, kontingjenti tij ushtarak ishte shpërndarë në formacionet mbrojtëse në Kotorr, Ulqin e Tivar. Ulqini ishte dorëzuar pa luftë dhe sidomos Tivari që kishte një pozitë më të favorshme, kështu që Bruti së bashku me prijësin tjetër ushtarak Montego kishte arratisur pjesën e ushtrisë në drejtim të Kotorrit.<sup>105</sup> Kështu, Kotorri mbeti qendra e asaj që me shekuj do të quhet “Shqipëria venikase”.

<http://ëëë.drita.info/2016/02/22/imzot-nike-prela-ipeshkev-i-shquar-dhe-i-dalluar-1918-1996/>. Bisedë personale e autorit me të ndjerin ipeshkvin Prela.

<sup>101</sup> Shih, Miroslav Montani, *Uz kamene spomenike na otoku sv.Dorda kod Perasta*, 365-366, Milošević, op.cit, 25, fusnota 9.

<sup>102</sup> Petar D. Šerović, *Odakle su bili porjeklom “mistri Goghe”*. 409-410, Milošević, op.cit, 25, fusnota 9.

<sup>103</sup> Miloš Mlošević, *Boka Kotrorska, Bar i Ulcinj od XV do XVII vijeka*, Cid., *Podgoprca*, 2008, 66-69

<sup>104</sup><sup>104</sup> Mlošević, op.cit. 66; Shih edhe Grga Novak, *Mletačka upustvan I izveštaji MSHSM, IV, Zagreb, 194.*

<sup>105</sup> Mlošević, op.cit. 68

Në kundërpërpjekjen që të merret ushtarakisht Hercegnovi si kompensim vdiq edhe Fran Dukagjini.<sup>106</sup>

Marrëdhëniet e Bokës së Kotorrit me shqiptarët në kohë otomane mund të vëzhgohen në kuadër të përmbysjeve të mëdha gjeopolitike, sidomos pas Betejës së Lepantit (1571) – që reflektohen edhe me piratërinë dhe kusarinë në det. Këtu vijjnë në shprehje piratët e njohur të Ulqinit në njërin anë dhe të Perastit në anën tjetër, nën venedikasit.<sup>107</sup>

Pas gati një shekulli e gjysmë të dominimit venedikas (1406 - 1571) Ulqini kishte kaluar në duart osmane, ndërsa pika më strategjike e prezencës venedikase pas rënies së Shkodrës (1492) u zhvendos në Kotorr. Ky riformatizim gjeopolitik i “Albanias Veneciane”, që e ndau në dysh kontrollin e Adriatikut, solli një rajon të ri kufitar mu në këto troje, ku Ulqini dhe Boka e Kotorrit u bënë hapësirë kufitare duke u gjendur në anët e kundërta të blloqeve politike, kulturore, civilizuese e tregtare.

Me vendosjen e otomanëve në Adriatik u trimërua piratëria si formë e luftës me venedikasit dhe fuqitë e tjera katolike të Perëndimit dhe e kundërta. Algjerianët dhe detarët berberë ishin pjesë e paevitueshme e këtij konflikti që e mbante peng Mesdheun kohë të gjatë. Besohet se detarët dhe piratët e njohur nga vendet berbere, si Algjeria, Maroku, të udhëhequr nga admirali i Tripolit Ulugj-Ali Karahoxha, ishin vendosur në Ulqin mu në vitin 1571 me 400 piratë, kur ky qytet u mor nga Venediku.<sup>108</sup>

Ulqini, që nga kjo periudhë deri te luftërat e Qipros (1570-1573) Kandisë (1645-1669) dhe Moresë (1684-1699), si dhe Paqja e Pozharevcit deri diku në shekullin XVIII, bëhet shpeshherë pika më kokëçarëse në gjitha raportet diplomatike që nga Venediku, Spanja e deri te Franca, që shpesh nuk dëgjonte as Stambollin, edhe kur sulltanët merren vesh me forcat perëndimore për të ndërprerë piratërinë në Adriatik për të siguruar tregtinë dhe lëvizjen e lirë në det.<sup>109</sup>

Kështu, vetëm në periudhën gjysmëshekullore (1691-1740) janë regjistruar rreth tridhjetë përlëshje detare të anijeve nga Perasti me piratë

<sup>106</sup> Mlošević, op.cit. 69

<sup>107</sup> Vesna Miović-Perić, *Ulcinjani i Dubrovačka Republika u prvoj polovici XVIII.stoljeća*, Zavod za povijesne znanosti HAZU, Dubrovnik, Anali, 30-1992, 99-116

<sup>108</sup> Op.cit, 99

<sup>109</sup> Lovorka Čoralić, Maja Katušić, *Gente di mare della nazine bochese – boklejske tartane i mletacko vojna podrška intervencija u Africi 1766 godine*, Hrvatski Institut za Povjest, Zagreb, 285

nga Ulqini, të cilat zakonisht kanë mbaruar me dëme për transportuesit nga Perasti.<sup>110</sup>

Perasti i ka pasur edhe dy sulme të rënda të piratëve otomanë më 1568 dhe sidomos më 1624, kur janë rrëmbyer mbi 400 qytetarë nga Perasti, që i bije ¼ e banorëve të asaj kohe. Në këtë aksion kryesorë ishin ulqinakët.<sup>111</sup> Në fakt, ky ishte rasti kur më së shumti qytetarë të Bokës janë zënë robër. Disa burime përmendin 450 të arrestuar nga gjithsej 600 banorë, përfshirë edhe kryetarin e qytetit, i cili, pa ndihmën e Venedikut, nuk mundi të siguronte shumën e kërkuar prej 1350 realëve për t'u liruar nga ulqinakët. Jo rrallë marrja peng e “robërve të bardhë” që shpaguheshin kundrejt një çmimi të lartë, ishte një veprimtari e njohur dobiprurëse e për ulqinakët.<sup>112</sup>

Konflikt ndërmjet Perastit e Ulqinit kishte edhe më 1636, por më 1637 ishte një pajtim i përkohshëm ndërmjet ulqinakëve dhe banorëve të Perastit, Budvës dhe Pashtroviqëve.

Çështja qëndronte në një gjeopolitikë komplekse në akuatoriumin e Adriatikut, pasi që në fjordin më të madh të këtij deti, Bokën e Kotorrit strategjike prej 86 kilometrash katrorë kishin qasje të dyja superfuqitë detare të kohës - Venediku dhe Perandoria Osmane. Për dy shekuj hyrja në fjordin e Bokës së Kotorrit ishte në një kanal të ngushtë detar në vijën Rt Oštro - Verige –Perast, të ndarë pothuajse në dy pjesë të barabarta, ku Hercegnovi dhe Risani i takonin osmanëve, ndërsa, Perasti e Kotorri ishin në anën venedikase.<sup>113</sup> Ishte kjo një lloj “luftë e ftohtë” mesjetare, që shpesh shndërrohej në luftime shumë reale. Në këso rrethanash, lufta e spiunazhit dhe kundërspiunazhit në një hapësirë të ngushtë ishte shumë prezente dhe përcaktuese.<sup>114</sup>

<sup>110</sup> Tomislav Grgurevic: Bokelji u borbi protiv gusara i pirata, [https://www.montenegrina.net/pages/pages1/istorija/odcrnojevica\\_dopetrovica/bokelji\\_u\\_borbi\\_protiv\\_gusara\\_i\\_pirata\\_t\\_grgurevic.html](https://www.montenegrina.net/pages/pages1/istorija/odcrnojevica_dopetrovica/bokelji_u_borbi_protiv_gusara_i_pirata_t_grgurevic.html)

<sup>111</sup> <https://archive.org/details/osmanski-pohod-na-perast-1624>

<sup>112</sup> Detarët ulqinakë shpesh i zinin robër anëtarët e ekuipazheve të tjera dhe i shitnin, sikurse që ishte rasti me Lucija Mrvi nga Përçanji i Bokës së Kotorrit, e cila pagoi për lirim të burrit të saj 130 talirë. Po kështu, përmendet edhe njëfarë Bozha Tripov që si rob kishte vdekur në Ulqin, më 15.8.1669. Shih, Bahri Brisku, *Deti dhe detarët në letërsinë popullore shqiptare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2006, 71; Ylber Hysa, *Shqiptarët dhe tjerët: Nga Madona e Zezë deri te Molla e Kuqe*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019, 75.

<sup>113</sup> Tomislav Grgurevic: *Bokelji u borbi protiv gusara i pirata...*

<sup>114</sup> Miloš Mlošević, *Boka Kotrorska, Bar i Ulcinj od XV do XVII vijeka*, Cid, Podgoprca, 2008, 72

Otomanët, nën kapëdinin e famshëm Hajredin Pasha Barbarosa kishin arritur të pushtonin Hercegnovin më 1481, shumë më herët se sa Ulqinin më 1571 dhe atëherë në hyrjen e gjirit, përmes ngushticës në *Verige*, mund të hynin anijet e dy palëve ndërluftuese. Perasti ishte mu drejt në hyrje të kësaj ngushtice dhe nuk ishte qytet i rrethuar sikurse Kotorri me mure rrethuese impesive prej 4,5 kilometrave, ndoshta fortifikimi më i madh venedikas në rajon, pas Korfuzit. Kështu, Perasti u shqua si një bazë e fuqishme detare në të cilën llogariste Venediku, ndërsa në anën tjetër ishte Ulqini, herë për llogari të otomanëve, herë për llogari të veten. Me rënien e Hercegnovit në shek. XVII në duar të venecianëve, Perasti u çlirua nga ky ngërç, por kjo nuk i ndaloi ulqinakët të vazhdonin avazin e vjetër. Ata madje, refuzonin të dëgjonin edhe Sulltanin për ndërprerjen e aktiviteteve pirateske në det. Prandaj, përveç fermanëve kishte edhe ekspedita ndëshkuese të të deleguarve specialë nga oborri i Sulltanit, që shkatërruan anije apo shtëpi e prona të kapëdaneve ulqinakë. Kështu, armëpushimi i njohur në mes superfuqish të kohës, i njohur si Paqja e Pozharevcit, e kishte pikë të veçantë ndërprerjen e aktivitetit piratesk të Ulqinit në det.

Në fakt, ulqinakët vazhduan të rrezikojnë detarët e Bokës e Perastit edhe kur kjo hapësirë kaloi në duar të Mbretërisë Franceze, sa që ulqinakët sulmuan anijet franceze në det të hapur sikurse kur detyruan ankorimin e saj të detyrueshëm në Vlorë për çka pati reagim direkt të Ambasadës Franceze në oborrin e sulltanit.

Por, përveç përleshjeve dhe konkurrencës detare, Boka e Kotorrit në flamurin venedikas, ka bërë tregti me bregdetin shqiptar përmes detarëve dhe anijembajtësve nga kjo hapësirë me limanet në Shkodër, Durrës, Vlorë. I tillë ishte Antun Luković nga Prčanj, i cili e drejtonte tartanën e regjistruar në dokumente venedikase (më 10 korrik 1766), e quajtur *Natività del Signore*, pronësi e ndërmarrësit tregtar detar nga Dobrota afër Kotorrit, Bože (Nadal) Kamenarović (1723. – 1788.) që ka bërë tregti me portet shqiptare gjatë mesit të shek XVIII me Shkodrën, Vlorën e Durrësin.<sup>115</sup>

Pronarët e njohur të anijeve tregtare me disa gjenerata Ivanovic nga Dobrota kanë pasur 28 anije në pronësi me filialin e tyre tregtar edhe në Durrës gjatë shek. XVIII.<sup>116</sup>

<sup>115</sup> *Gente di mare...*, 290

<sup>116</sup><sup>116</sup> Hrvatski Leksikografski leksikon, Leksikografski Zavod Miroslav Krleža, 2009 – 2020 (ed. Miljenko Foretić).

Gjatë shek. XVIII në panairë të ndryshme ekspozonin mallrat e tyre ndërmarrësit dhe tregtarët nga Boka e Kotorrit në të dyja anët e Adriatikut, në Itali, Dalmaci, Korfuz, përfshirë edhe Shqipërinë.<sup>117</sup> Ruta tradicionale e anijeve dhe tregtarëve kottorras ishte Pulja, Greqia, Dalmacia, Shqipëria dhe Levanti.<sup>118</sup>

Gruri nga limanet shqiptare ishte një produkt shumë i kërkuar në pjesët tjera të Adriatikut, që shpeshherë eksportohej me anijet nga Boka e Kotorrit. Ato shpesh ishin edhe cak i sulmeve pirate nga Ulqini.<sup>119</sup>

Por, detarët nga Boka e Kotorrit kanë marrë pjesë po ashtu në ekspeditën e pasuksesshme të përpjekjes venedikase për të rimarrë Tivarin e Ulqin në më 1717-1718.<sup>120</sup>

Në fakt, fundit të Luftës së Moresë (1684-1699), ulqinakët tashmë u paraqitën edhe si forcë tregtare. Ata tashti kishin plot 300 anije në zotërim<sup>121</sup> dhe bënë konkurrencë serioze për Bokën venedikase, e cila dikur kishte pasur 200 anije, ndërsa tani vetëm 20 sosh, falë sulmeve shkatërruese të ulqinakëve.<sup>122</sup> Venedikasit frikësoheshin se në këto situata francezët me importet dhe anijet e tyre do të mbizotëronin tregtinë në këtë pjesë të Adriatikut. Këtë vakum synonin ta zinin ulqinakët duke dashur të bënin monopol mbi tërë limanet shqiptare.

Flota tregtare-detare ulqinake ishte konkurreuese direkte e Perastit, të cilit i shkaktoi shumë dëme, sa që, sipas pohimeve të konsullit venedikas në Durrës, nga këtu dikur shkonin 16000-18000 ngarkesa mallrash për Venedik nga tregtarët e Bokës, e më 1725 arritën në vetëm 4 apo 5 anije.<sup>123</sup> Përkundër një fuqizimi të madh të tregtarëve nga Shkodra e Ulqini, Perasti dhe tregtarët e Bokës megjithatë e ruajtën një

<sup>117</sup> Tina Ugrinić Marija Knežević, ODNOSI IZMEĐU DVIJE JADRANSKE OBALE (Boka Kotorska i Italija), 290

<sup>118</sup> Radomir Prica, *Grada za istoriju kotorske trgovine (od 1587 – 1603)*, Spomenik SAN CV, Beograd, 1956, 45-47

<sup>119</sup> Miloš Mlošević, *Boka Kotorska...*, 223

<sup>120</sup> M. Milošević: Oko neuspjelog pokušaja osvojenja Bara i Ulcinja 1717. i 1718. godine. Istorijski zapisi (Titograd), 13(1960) XVII/4, str. 793, 801.

<sup>121</sup> V. Vinaver, *Pomorstvo Ulcinja u XVIII veku*, Istorijski zapisi XVI, knj. XX, sv. 1, Titograd, 1963, 51-68

<sup>122</sup> Në Ulqin, sipas raportit të konsullit francez në Shkodër, më 1776 ndeshën dhe anijendërtuesit me zë nga Dubrovniku e Korçulla sikurse Luka Rodić (1774) e Antun Pilat (1784), por shquheshin edhe ndërtuesit vendorë nga Ulqini e Tivari, si Jus Omeri, Salihi e Usta Osman Beqiri, Adem Tivari, etj. *Milošević*, op.cit, 165

<sup>123</sup> Milošević, op.cit, 179

Iloj prezence në Durrës në drejtim të Venedikut, ku shquhej eksporti duhanit.<sup>124</sup>

Në anën tjetër, përmendet edhe aktiviteti piratesk nga ana e Perastit.<sup>125</sup> Në mes Perastit e Ulqinit kishte në fillim bashkëpunim, por më vonë edhe një “luftë të vogël” mes tyre, sidomos pas aksionit të lirimt të gruas së piratit të njohur peratas Krilo (Cvjetković) nga burgu i Shkodrës, sa që kjo gati shkaktoi konfliktin e ri në mes të Venedikut e otomanëve.<sup>126</sup>

Në fakt, në disa raste si në shek. XVII ka edhe instruksione direkte për providurin gjeneral venedikas lidhur me bashkëpunimin e “disave nga Budva, Perasti, Pashtroviqi e Kotorri me anijet turke të Hercegnovit, Ulqinit e Lezhës”. Sugjerohet aksion tërheqjeje vërejtjes parandaluese para se të shqiptohen dënimi për këto bashkëpunime me qëllime të përbashkëta pirateske.<sup>127</sup>

Në këtë mishmash, ku kishte akuza të ndërsjella dhe kur vështirë dallohej një anije tregtare prej asaj pirate nga Ulqini, sepse ata merreshin tani me të dyja aktivitetet, ndodhi një situatë e re konfliktuale. Mu për shkak të ankesave tani të ulqinakëve karshi venedikasve dhe kontrollit të tyre në Bokë të Kotorrit, pasuan arsyet formale për shpalljen e luftës së re që Porta ia bëri Venedikut.<sup>128</sup>

### Stradiotët

Është interesante se në arkipelagun e Tivatit ishulli i Shën Markut në mesjetë ishte quajtur *insulio s. Gabrelis*, por që në periudhën venedikase në shek. XVI e XVII morri emrin *Stradioti*, për shkak të ven-

<sup>124</sup> Nga mallrat e transportuara përmendën lëkurat, pambuku, dylli, duhani, Shih, Milošević, op.cit, 179

<sup>125</sup> Shquheshin Vicko Ivanov Markovic që më 1530 kishte ikur në Afrikën Veriore, pastaj ishte helmuar nga venedikasit. Me piratëri ishin marrë dhe Vicko Stepanov (1630) e Niklola Tomin (1700). Shih, Milošević, op.cit 223-224

<sup>126</sup> Miro Montani, *Pomorstvo perasta u portretima bordova*, Pomorski Zbornik II, Zadar, 1962; Aleksadnar Solovjev, *Paštovačke isprave XVI-XVIII veka* Spomenik SKA LXXXIV, Beograd, 1936, Milošević, op.cit, 223-225

<sup>127</sup> Milošević, op.cit, 223-225

<sup>128</sup> Vesna Miović-Perić, *Ulcinjani...*, 100-102; V. Vinaver, *Pomorstvo Ulcinja u XVIII veku*, Istorijски zapisi, Istorijски institut i Istorijско društvo NR Crne Gore, knj. XX, Titograd, 1963, str. 51-55. S. Mijušković, *Turske mjere protiv ulcinjskih gusara*, Godišnjak Pomorskog muzeja u Kotoru, XII, Kotor, 1964, str. 73-76. Miscellanea, HAD, XVIII stoljeće, F IX, br. 4, 5

dosjes së ushtarëve të njohur që përdorte Venediku nga ishujt grekë e gjetiu.<sup>129</sup> Në fakt, siç dihet dhe nga praktikat tjera, mjaft nga këta stradiotë ishin arbëreshë dhe si të tillë fituan nam si mercenarë në Itali dhe Evropë.<sup>130</sup>

Në ishullin e Shën Gabrielit ishin vendosur dy çeta te stradiotëve – kalorësve profesionistë, si bazë mbështetëse e fortifikuar për nevoja të mbrojtjes së interesave veneciane në Bokë të Kotorrit dhe më gjerë. Asaj i ishin dedikuar edhe 40 dukatë më 1499 që të ngritje fortifikimin në fjalë.<sup>131</sup> Me këto shpenzime, sipas këshillave të providurit venecian, mbulohej fortifikimi në Stradioti afër Tivatit dhe ura në drejtim të Prevlakës, ngushticës strategjike që kontrollon hyrjen në ngushticën e njohur. Më vonë, më 1542, ujdhesa do të duhej të kishte tri anije fuste në dispozicion si dhe të mbulohej me një kullë vrojtuese dhe mure rrethuese, sipas kërkesës së providurit Ripa.<sup>132</sup> Stradiotët pjesërisht paguheshin nga monopoli i qarkullimit të kripës nga Korfuzi, Venediku apo edhe arkat e komunave, të cilat ishin të obliguara që të mbulonin edhe vendbanimet për ta, sa që nganjëherë kishte ankesa, sikurse në Ulqin.

Ndryshe ishte në Kotorr, ku kishte një bazë permanente. Stradiotët këtu u vendosën në ishullin e Shën Gabrielit, pra më larg qytetit. Aty përmendet një kontigjent prej 20-25 stradiotësh.<sup>133</sup> Në fakt, falë tyre edhe vetë ishulli mori toponimin *Stradioti*, që vlen edhe sot.

Stradiotët ishin komunitet profesionistësh ushtarakë në formën e kalorësisë së lehtë, që zakonisht vinin nga hapësirat ballkanike ku kishte mbizotëruar Venediku dhe përbëheshin zakonisht nga shqiptarët, grekët, kroatët.

Më 1575 shënohen 136 stradiotë me 3 kapitenë, shumica e tyre shqiptarë.<sup>134</sup> Ata, pas një kohe, sollën edhe familjet e tyre dhe nganjëherë ishin telashe për vetë komunitetin, sidomos kur Venediku vonohej t'i paguante me rroga, sa që ata lanë nam në komunitetin e Bokës së Kotorrit dhe përreth. Kështu, është shënuar që sindiku Justiniani propozoi për arsyeje sigurie dhe politike që shqiptarët të ndërroheshin me kroatë nga Dalmacia, ndërsa shqiptarët të dërgoheshin në shërbim në

<sup>129</sup> M.Zorinja, p.cit, 75

<sup>130</sup> Shih: Paolo Petta, *Stradiotet, Ushtarë shqiptarë në Itali (shek.XV-XIX)*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2006

<sup>131</sup> Miontani, *Pomorstvo...*, 1862, Milošević, 46

<sup>132</sup> Milošević op.cit

<sup>133</sup> Milošević, 50

<sup>134</sup> Milošević, 51-52

Dalmaci. Por, për shkak të situatës së jashtëzakonshme dhe kërcënimit luftarak, stardiotët u mbajtën mu në bazën e tyre në ishullin e përmendur dhe për këtë madje u ndërmorën restaurime të shtëpive të tyre dhe fortifikim i infrastrukturës.<sup>135</sup>

### **Kotorri dhe politika e kundër-reformacionit në brendësi të Ballkanit dhe shqiptarët...**

Pas rënies së Ulqinit dhe Tivarit shumë shqiptarë migruan në territoret venedikase në Budvë dhe Kotorr.<sup>136</sup> Atëherë, shumë shqiptarë, si njohës të terrenit dhe të gatshëm për t'u rebeluar kundër pushtimit otoman u imponuan si aktorë kryesorë dhe ndërmjetës në planet ambicioze të politikave papale për të çliruar këto territore nga ndikimi otoman, sidomos nga fundi i shek. XVI deri tek Lufta e Kandisë. Por, Venediku ishte shumë i kujdesshëm në këto përpjekje duke mbrojtur politikat e status quos. Providuri në Kotorr ishte shpesh referencë në shumë nga këto episode.<sup>137</sup>

Përpjekjet e Papës Klementi VIII për një kryqëzatë antiosmane me bazë Ballkanin nuk pushuan gjatë kohës së tij. Shqipëria bregdetare venedikase dhe brendia e saj malore, pjesë e ndërlidhur me Malin e Zi dhe Hercegovinën, ishin hapësirat ku ishte shtrirë interesimi për mobilizimin e lëvizjeve antiosmane, që shpesh e brengosnin Venedikun.<sup>138</sup> Në këto përpjekje, Spanja, jezuitët dhe Dubrovniku (e jo Venediku), u bënë baza të ndërtimit të rrjeteve e konspirative. Jezuitët e bënë Dubrovnikun qendër të tyre rajonale. Shef për prezencën jezuite në Dubrovnik ishte vizitatori papal, Aleksander Komulovic, që nga viti 1604.<sup>139</sup>

Për arsye se autoritet venedikase tashmë kishin marrë masa preventive në bazën e tyre në Kotorr, Dubrovniku u bë ndërlidhje e sigurt e komunikimit spanjoll me përpjekjet kryengritëse në Shqipëri. Dhe prapë ndërmjetësi më i besuar i këtyre përpjekjeve spanjolle ishte

<sup>135</sup> Op.cit, 50-53

<sup>136</sup> Gligor Stanojević, *Dokumenti o zavjeri albanskih prvaka iz 1602. godine, Balcanica 3, Godšinjak Balkanološkog Instituta, SANU, Beograd, 1972, f.300*

<sup>137</sup> Shih, Ylber Hysa, *Madona e Zezë në Kosovë: Ndërmjet Dea Dardanicas dhe Kundër-Reformacionit*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019, 230-250

<sup>138</sup> Shih, Peter Bartl, *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane, Mbi çështjet e luftës antiturke në kapërcyell të shek. XVI dhe XVII*

<sup>139</sup> Zlatar, 267.

Komulovic.<sup>140</sup> Në fakt, nga të gjitha karakteret që përmendeshin në intrigat e përpjekjet dhe kundërpërpjekjet e spiunazhit dhe kundërspiunazhit të aktorëve në këtë teatër spanjollo-papalo-venedikas, venecianët konkluduan se të gjithë të tjerët mbase ishin peshq të vegjël krahasuar me Komulovicin. Atë, providuri gjeneral venedikas, e cilësoi si “instrument (spanjoll) në çështjet e Kotorrit dhe Shqipërisë si dhe të Klisit”. Prej se e kishte lënë punën te kolegji jezuit, nga viti 1595, dymbëdhjetë vjet më herët, asgjë nuk ka ndodhur e që ai (Komulovic) të mos ishte protagonist. Përparësia e tij ishte njohja e gjuhës “ngase ai ishte një fisnik nga Spliti”, i shpjegonte qeverisë së tij providuri i përgjithshëm, duke theksuar në fund se Komulovic me qëllim kishte përzgjedhur si më të përshtatshëm Dubrovnikun si bazë veprimi dhe vendbanimi 8 vjet më herët, që i bie diku në vitin 1595.<sup>141</sup>

Aktivitete të tjera të përpjekjeve antiosmane, që e ndërldhin Komulovicin, janë ato të vitit 1607. Prapë është providetori venecian që ka informacione për këto aktivitete dhe ai e njofton republikën e vet nga Kotorri se napolitanët po synonin të dërgonin “une berton benissimo armato”, një anije të armatosur, që ishte pronë e raguzanit, kalorësit George Dolisti, e që ishte në shërbim spanjoll.<sup>142</sup>

Në fakt, kjo, si shumë përpjekje tjera të ngjashme të shekujve XVI e XVII, mbaruan pa ndonjë epilog serioz.<sup>143</sup>

Në këtë episod historik, që përfshin sidomos shqiptarët si aktorë, Kotorri bëhet një nga qendrat në këtë aktivitet spiunazhi e kundërspiunazhi këndeje e andej Adriatikut. Kështu, *Stato di mar*, përmes Kotorrit si pozicion kyç ishte në mes të papatit, mbretërisë Spanjolle dhe Perandorisë Osmane në këto përpjekje gjeopolitike të kohës.

\* \* \*

Siç mund të shihet, komunikimi historik i shqiptarëve me Kotorrin ka qenë shumëdimensional – politik, fetar, ushtarak, kulturor, detar etj.

<sup>140</sup> Zlatar, 267.

<sup>141</sup> SS Dispaci RPDA, 1607, (Tomic, 418-419), Zlatar, 268, fusnota 35.

<sup>142</sup> SS Dispaci RPDA, 1607, (Tomic, 418-419), Zlatar, 268, fusnota 35.

Tomic, Letra e 17 marsit 1607, e datuar në Zarë. Dokumenti gjendej në pronësi të Tomicit, i cili nuk e ka indikuar lokacionin e ruajtjes. Zlatar, 267, fusnota 31

<sup>143</sup> Shih, Gligor Stanojevic, *Jugoslovenske zmlje u Mletačko-Turskim ratovanjima XVI-XVIII vijeka*, Beograd, Istoriksi Institut u Beogradu, Beograd

Kotorri ishte një nyjë e rëndësishme adriatikase përgjatë gjithë mesjetës e deri te kohëra më të reja. Ishte një liman nga më të rëndësishmit që nga Dubrovniku e deri te Durrësi. Kjo, sidomos fal edhe specifikes natyrore: fjordit më të madh në këtë pjesë të Mesdheut.

Kotorri, herë si një qytet me status të ruajtur autonom, brenda apo jashtë strukturave të tjera shtetërore të kohës, e më së shumti të Bizantit, Nemanjiqëve, apo Venedikut, ishte qyteti që kurrë nuk ra nën Perandorinë Osmane.

Marrëdhëniet e Bokës së Kotorrit me shqiptarët mund të vëzhghohen në kuadër të përmbysjeve të mëdha gjeopolitike, sidomos pas betejës së Lepantit (1571) – që reflektohen edhe me piratërinë dhe kusarinë në det. Nga një ish-tërësi politiko-kulturore, tani këto marrëdhënie të shqiptarëve me Bokën e Kotorrit konvertohen brenda një krahine dinamike kufitare me shumë implikime gjeopolitike. Këtu vijnë në shprehje piratët e njohur të Ulqinit në njërin anë dhe të Perastit në anën tjetër. Pas gati një shekulli e gjysmë të dominimit venedikas (1406-1571) u bë riformatimi gjeopolitik i “Albanias Veneciane” që e ndau në dysh kontrollin e Adriatikut dhe solli një rajon të ri kufitar mu në këto troje.

*Albania Venciane*, që mbeti në Kotorr, vazhdoi edhe më tutje të ishte një emërtim i memories dhe ambicies, edhe shumë shekuj pasi që pjesa shqiptare e bregdetit mbeti nën Perandorinë Osmane.

Si i tillë, Kotorri ishte një nyjë Adriatiku e ndërlidhur edhe me shqiptarët në episode e rrethana të ndërthurura historike, që nganjëherë duket si një storie e harruar.

## **BOCA DI CATARO AND ALBANIANS DURING CENTURIES: THE FORGOTTEN ADRIATIC CONNECTION**

### **Summary**

Kotor with its fiord has been an insurmountable point between the Adriatic and the Balkan interior, an essential gravitation in historical, commercial, cultural and geopolitical communication throughout its long history. Therefore, Kotor had inevitable communication with the Albanians, not so far geographically.

Our focus on the communication of Albanians with Kotor is mainly in the medieval context. In this respect, the communication of Albanians with medieval Kotor is contextualized in several chapters within certain historical context.

The first one is related to the early presence of the Benedictines in Zeta and northern Albania, an important role in the strengthening and spread of Christianity in these areas since the 9th-12th centuries. An interesting episode of this communication of Albanians with Kotor is related to the promotion of the iconic cathedral, a symbol of the city since 1166 and the role of the Albanian Catholic clergy. During the period of the Nemanjics the presence of the Albanians there is specifically related to that of the Vlachs in the surroundings of Kotor Bay, but also Dubrovnik. The other context is that of the period of Venetian's governance, where this geopolitical space was conceived as *Albania Veneta*. Another contact was related to the role Kotor had in an early jurisdiction of the Catholic churches in Kosovo. An interesting aspect is related to the role of personalities from *Boca di Cataro* in Albanian history and culture and its diaspora. A special chapter is also related in post-Lepanto era: Kotor and the Albanians after the fall of Ulcinj and Tivar in Ottoman hands, the role of Ulcinian piracy, as well as the maritime-commercial reflections in a new historical, geopolitical constellation of the time.

The historical communication of Albanians with Kotor has been multidimensional – political, religious, military, cultural, maritime, etc.